



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI JURIDIK E DREJTA PENALE

-PUNIMI I MAGJISTRATURËS-

**Tema: “Instituti i avokatisë, roli dhe rëndësia e avokatit në
procedurë penale në Republikën e Maqedonisë së
Veriut”**

Mentori

Prof. dr. Besa ARIFI

Kandidatja

Emel OSMANI

Tetovë, 2019

Shkurtesat

LPN	Ligji i procedurës ndërgjyqësore
LPP	Ligji i Procedurës penale
DUPNJ	Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut
KEDM	Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut
PNDC	Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike
LGJ	Ligji i Gjykatave
LTGJ	Ligji i taksave Gjyqësore
RGJ	Rregullorja Gjyqësore
LNPLPN	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë ndërgjyqësore
KP	Kodi Penal
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut
KEDNJ	Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut

Abstrakt

Ky studim, nëpërmjet analizës që i bën institutit të avokatisë, duke e parë atë në lidhje të ngushtë me sistemin gjyqësor, trajton rolin dhe rëndësinë që luan ky institut në sistemin e sotëm të drejtësisë, si dhe nevojën e reformimit të tij në përputhje me standardet e gjithëpranuara ndërkombëtare. Në një këndvështrim historik, studimi prezanton evoluimin e institutit të avokatisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në situatën aktuale-raportin e tij me gjykatën dhe me individin, si dhe rolin e avokatit në procesin penal me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

Nga ana tjetër duke u referuar rezultateve të hulumtimit ku u anketuan 58 avokatë për sfidën, natyrën dhe vendndodhjen e institutit të avokatisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut rezultoi se dominojnë deklaratat negative që konsiderohej si sfidë e rëndë që shfaqet si e pafuqishme ndaj sistemit shoqëror dhe gjyqësor, më pas që ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve sipas grupmoshës së tyre, poashtu që ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve sipas viteve përvojë si avokat dhe që ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve sipas llojit të avokatisë që bën, pra, u konstatua se sistemi gjyqësor në tërësi duhet reformuar sipas rekomandimeve dhe rezultateve të hulumtimeve të organizatave joqeveritare dhe raporteve evropiane.

Fjalë kyçe: *E drejta humane; Instituti i avokatisë; Avokati; Kodi etik; E drejta për përfaqësim dhe mbrojtje;*

PËRMBAJTJA

Shkurtesat.....	2
Abstrakt.....	3
Hyrje	6
I. SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT DHE GJENDJA AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	10
1.1 E drejta njerëzore themelore.....	10
1.2 Legjislacioni aktual i Republikës së Maqedonisë së Veriut që siguron të drejtat themelore civile dhe procedura penale	12
1.2.1 E drejta për përfaqësim dhe mbrojtje.....	15
II. KONCEPTI I INSTITUTIT TË AVOKATISË DHE GJENDJA AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	25
2.1 Profesioni i avokatit dhe roli i tij në shoqëri, në një këndvështrim historik	25
2.2 Përshkrimi i profesionit.....	28
2.3 Kodi etik dhe marrëdhëniet e avokatit	30
2.4 Gjendja aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut	34
2.3.1 Cënimet e të drejtave themelore për qasje në avokat në procedurën penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut	35
2.3.2 Jo aktiviteti i avokatëve zyrtarë pa pagesë.....	38
III. METODOLOGJIA E STUDIMIT	41
3.1 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit.....	41
3.2 Fokusi dhe detyrat e hulumtimit	41
3.3 Metodatat e hulumtimit.....	41

3.4 Teknikat dhe Instrumentet e hulumtimit.....	43
3.5 Pjesmarrësit në hulumtim	44
IV. PREZANTIMI I REZULTATEVE DHE FREKUENCAT SIPAS QËNDRIMEVE TË AVOKATËVE.....	47
4.1 Gjendja aktuale sipas qëndrimeve të avokatëve	47
4.2 Analizat e qëndrimeve sipas dallimeve socio-demografike të avokatëve	49
V. PËRMBLEDHJA E KONKLUDIMEVE DHE DISKUTIMI.....	55
5.1 Përmbledhja e konkludimeve.....	55
5.2 Përfundim dhe rekomandime.....	56
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	60
SHTOJCA.....	63
1. Grafikonet me frekuencat e përgjigjeve të anketarit (12 pyetje)	63
2. Pyetësi për Qëndrimet e avokatëve për profesionin e tyre, rolin dhe rëndësin e tyre në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	69

Hyrje

E drejta për mbrojtje është institut i ndërlikuar procedural penal. Për të kuptuar esencën e saj duhet fillimisht t'i qasemi kuptimit dhe përkufizimit etimologjik të saj. Nocioni mbrojtje (avokat) gjenezën e ka nga folja e gjuhës latine *advoco* që do të thotë të thërrasësh Zotin për ndihmë, dhe në bazë të kësaj domethënie do të arrijmë deri te esenca e kuptimit gjuhësor dhe përkufizimit të nocionit mbrojtje.

Në kuptim procedural penal mbrojtja mundet të definohet si aktivitet procedural, i orientuar ta sulmojë padinë në tërësi apo pjesërisht, e cila ka si qëllim gjetjen e fakteve dhe rrethanave, që do të shkojnë në interes të të akuzuarit gjatë një procesi procedural penal. Nga Revolucioni Francez në fund të shekullit XVIII, kjo e drejtë llogaritej si e drejtë natyrore e qytetarit, e cila nuk ka mundësi që me ligj t'i merret, por vetë duhet të përcaktohen rregullat se kur mundet të realizohet kjo e drejtë. Ekzistimi i të drejtës për mbrojtje nuk është vetëm në interes të qytetarit që ballafaqohet me shtetin dhe aparatit e pushtetit, por është në interes të shoqërisë si tërësi, e cila nuk ka asnjë arsye që i pafajshmi të dënohet, kurse fajtori t'i shmanget përgjegjësisë dhe dënimit të merituar. I dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale (Fenwick, 1997).

Gjegjësisht, shteti i ruan interesat dhe vlerat e tij të përgjithshme duke ua marrë kryesve të veprave penale disa nga të drejtat personale të tyre si që janë liria, dinjiteti, pasuria etj. E gjithë kjo duhet të bëhet në përputhje me sanksionet paraprakisht të parashikuara dhe në harmoni me parimin *nullum crimen sine lege*, *nulla poene sine lege* (nuk ka krim ose veprë penale, e cila nuk është e paraparë me ligj si e tillë, dhe nuk ka dënim që nuk është paraparë me ligj) (Fenwick, 1997).

Në këtë kontekst duhet ta shohim rëndësinë e mbrojtjes si i vetmi lajm i shpresës për personin, i cili ka gabuar rëndë në pikëpamje të vlerave vitale të shoqërisë si tërësi. Mbrojtja është e domosdoshme jo vetëm në rastin e procedurës penale të ndërlikuar e cila ka për qëllim që të vërtetojë se a është i dyshuari kryerësi i vërtetë i veprës penale, por edhe në rastet kur kruesi i veprës dihet që në fillim të procedurës në raste kur ai dë të kapet në flagrancë. Por edhe atëherë, edhe pse personi pa dyshim është kryerës i veprës penale, duhet të shikohet përgjegjësia e tij dhe

parandalimi që atij të mos t'i shqiptohen sanksione më të rënda kundrejt atyre që parasheh ligji për atë rast (Fenwick, 1997).

Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij. Me mbrojtjen i dyshuari jo vetëm që u kundërpërgjigjet sulmeve të akuzuesit, ai në të njëjtën kohë mbrohet edhe nga gabimet eventuale të gjykatës si dhe vendimet kundërligjore të tyre. E drejtë në mbrojtje, si njëra nga të drejtat themelore të njeriut, në mënyrë adekuate është përfaqësuar në numër të përcaktuar të akteve juridike ndërkombëtare që rregullojnë materien e lirive dhe të drejtave të njeriut (Fenwick, 1997).

Këtu para se gjithash duhet të potencojmë deklaratën e përgjithshme për të drejtat e njeriut e miratuar në vitin 1948 nga Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, e cila nëpërmjet parimit të prezumimit të pafajësisë parasheh dhe të drejtën e mbrojtjes në procedurë penale ku thuhet: “Secili që fajësohet për vepër penale ka të drejtë që të trajtohet si i pafajshëm, përderisa në bazë të ligjit në seancën kryesore nuk do të dëshmohet fajësia e tij, në të cilën duhet që të sigurohen të gjitha mekanizmat garantues për mbrojtjen e tij”¹.

Gjithashtu, Organizata e Kombeve të Bashkuara hartoj një Pakt Ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, i cili unanimisht u miratua në vitin 1966, me anë të cilit u përcaktua minimumi i garantimit, që i fajësuarit të ketë në dispozicion kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe të komunikimit me avokatin sipas zgjedhjes së tij, nëse nuk ka përfaqësues juridik, të njoftohet me të drejtën se këtë mundet ta ketë, dhe në rastet kur është në interes të drejtësisë, duhet t'i caktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, pa pagesë të shpenzimeve nëse nuk posedon mjete për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

Përveç kësaj edhe Konventa Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, e cila ka hy në fuqi vitin 1953, kur flet për të drejtat e të fajësuarit, ndër të tjerat thotë: “Secili i fajësuar ka të drejtë që të mbrohet ose vetë ose me ndihmën e avokatit që e zgjedh vetë, në rast se nuk posedon mjete financiare të mjaftueshme që të mbulojë këtë shërbim, ky shërbim duhet t'i ofrohet pa pagesë në rastet kur është në interes të drejtësisë”.

¹ The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985)

Kur miret parasysh rëndësia e të drejtës për mbrojtje plotësisht është e arsyeshme normimi kushtetues i saj nga ana e më shumë shteteve në botë. Mbi bazën e analizës për mënyrën se si e drejta për mbrojtje është e rregulluar shikuar nga prizmi i Konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare, mundemi të konstatojmë²:

- ✓ që të drejtë për mbrojtje dhe për mbrojtës ka çdo qytetar, dhe jo vetëm i dyshuari,
- ✓ se kjo e drejtë u është e garantuar jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe para organeve të tjera që kanë në kompetencë të zbatojnë procedura,
- ✓ se kjo e drejtë nuk ka mundësi të kufizohet me ligj,
- ✓ se askush nuk mundet të merret në pyetje nga policia pa prezencën e mbrojtësit, vetëm në rastet kur i dyshuari vullnetarisht heq dorë nga kjo e drejtë.

Pra, ky studim në vete ngërthen rolin, rëndësin dhe natyrën e institutit të avokatisë, si mbrojtës në procedurat penale dhe në përgjithësi në sistemin shoqëror e gjyqësor të Republikës së Maqedonisë si dhe analizat e konceptit, natyrës dhe strukturës së institutit të avokatisë dhe të avokatit.

² Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997)

KAPITULLI I

MAQEDONIA E VERIUT DHE TË DREJTAT

NJERËZORE

I. SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT DHE GJENDJA AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 E drejta njerëzore themelore

Fusha e të drejtave njerëzore dhe liritë themelore shënon një zhvillim intensive që prej shekullit XVII, por sërish, përjeton përhapje të vetë në fund të Luftës së Dytë Botërore, në kohën kur organizata të ndryshme ndërkombëtare mundohen të promovojnë rëndësinë dhe respektimin deri më-nëpërmjet miratimit të dispozitave ligjore-aspekte të ndryshme të drejtave të individëve. Gjatë kësaj, shtetet kanë marrë përsipër të respektojnë të drejtat e individit, në mënyrë që autoritetet janë të penguar pa arsyetim të drejtohen ndaj/mbi këto të drejtat siç është e drejta e jetës, lirisë, privatësisë dhe e drejta e pronësisë. Më tutje, të drejtat e njeriut, gjithashtu duhet të mbrohet nga përzjerja dhe shqetësimi i personave tjerë, ndërsa veçanërisht nga goditjet e qendrave e përqendrimit të fuqive, siç janë kompanitë dhe organizatat, përfshirë edhe mediet.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbrojtja e të drejtave të njeriut është siguruar në shtresa të ndryshme ligjore, nga ana e pushtetit publik si dhe nga ana e sistemit ligjor penal dhe qytetar. Mbrojtja themelore në nivel të organeve shtetërore është siguruar me anë të respektimit dhe plotësimi të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut³, si dhe me anë të marrëveshjeve të pranura globale ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuar (OKB) dhe në nivel rajonal, si dhe atyre në Evropë⁴, veçanërisht aktet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës.

Në pajtim me dispozitat e Kodit Penal⁵, mbrojtjen ligjore e siguron shteti, që, në interes të publikuar përcakton një sërë sanksionesh për kryerjen e veprave penale, madje edhe ndëshkohet edhe tentim për kryerje të veprës penale. E drejta qytetare, nga ana tjetër, i mbron intereset e individit dhe ka për qëllim të sigurojë baraspeshë mes interesave personale dhe intereset e tjerëve. Ajo merr parasysh shkakun në rastin konkret si dhe fajin e atyre të përfshirë; gjobat janë kryesisht të natyrës financiare dhe sanksionet varet nga pasojat që ka shkaktuar veprat e kryer

³ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 52/1991, 31/1998, 91/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009 dhe 49/2011)

⁴ Ligji për zbatimin e vendimeve të GJEDN (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.67/2009 dhe 43/2014)

⁵ Kodi Penal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015 dhe 226/2015)

penale, gjegjësisht dëmi i shkaktuar ose përfitimet e bëra nga kryerja e veprës. Ndalesa e aktiviteteve është e arsyetueshme vetëm kur është e mundshme të ndalohen ose zbuten pasojat e dëmshme të këtyre veprimeve.

E drejta për një proces të drejtë gjyqësor kalon dhe duhet përcjellur nga këto parime⁶:

- ✓ Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar sipas ligjit. Vendimi shpallet publikisht, por prania në sallën e gjyqit për përfaqësuesit e shtypit dhe për publikun mund të ndalohet kur një gjë të tillë e kërkon interesi i ruajtjes së moralit, rendit publik ose sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur e kërkojnë interesat e të miturve, mbrojtja e jetës private të palëve në gjykim, tërësisht ose në atë masë që gjykata e mendon rreptësisht të nevojshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.
- ✓ çdo njeri që akuzohet për vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin.
- ✓ çdo njeri që akuzohet për vepër penale ka këto të drejta minimale:
 - të vihet në dijeni brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe me hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij ;
 - të ketë kohën e lehtësitë e përshtatshme për të përgatitur mbrojtjen e tij;
 - të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës ligjore që e zgjedh vetë dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme që të paguajë për ndihmë ligjore, kjo t'i jepet pa pagesë kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - të pyesë vetë ose të kërkojë të pyeten dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në favor të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij ;
 - të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi gojor nëse ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjykatë.

⁶ Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997)

Ashtu siç mund të vërehet përsa më sipër, Neni 6 garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të hapur në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të një individi ose të ndonjë akuze penale kundër tij. Gjykata⁷, dhe më parë edhe Komisioni e kanë interpretuar gjerësisht këtë nen, me motivin se është me rëndësi themelore për funksionimin e demokracisë.

1.2 Legjislacioni aktual i Republikës së Maqedonisë së Veriut që siguron të drejtat themelore civile dhe procedura penale

Duke pasur parasysh sa është thënë më lartë lidhur me tendencat bashkëkohore për ridefinimin e pozitës së viktimës në të drejtën penale, lehtë mund të konstatohet se ligjet e Maqedonisë së Veriut që kanë të bëjnë me çështjet penale janë plotësisht të orientuara drejt kryerësit të veprës penale. Në qoftë se analizohet Kodi Penal i RMV-së në këtë aspekt, gjëja e parë që do të konstatohet është se termi “viktimë” nuk paraqitet fare në pjesën e përgjithshme të këtij kodi (ashtu si edhe në shumë vende tjera me sistem juridik kontinental, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut – në vazhdim KPRMV – përmban dy pjesë, pjesën e përgjithshme që ka të bëjë me konceptet e përgjithshme të krimit, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale dhe pjesën e posaçme që ka të bëjë me veprat konkrete penale); që do të thotë se viktimia nuk paraqet një subjekt të veçantë dhe të pavarur të të drejtës penale.

E gjithë pjesa e përgjithshme e KPRMV ka të bëjë kryesisht me kryerësin dhe të drejtat e tij. Kështu, po të merret në konsideratë neni 31 i KPRMV⁸ do të kuptohet që qëllimet e vetme të sanksioneve penale janë retribucioni, parandalimi specifik dhe i përgjithshëm (ndalimi i kryerësit ta përsërisë veprën penale si dhe ndalimi i të tjerëve ta kryejnë të njëjtën) dhe rehabilitimi i kryerësit. Restituimi dhe kompensimi i viktimës nuk përmenden fare si qëllime të sanksionit penal. Është e qartë që segmenti restorativ i drejtësisë penale në Maqedonin e Veriut akoma dukshëm mungon edhe ligjërisht.

I vetmi termin që është i përafërt me kategorinë e viktimave identifikohet në nenin 99 të KPRMV që flet mbi të drejtën e personit të dëmtuar të kërkojë restituimin e pronës së tij. Si që është përmendur më lartë, restituimi i pronës së dëmtuar është vetëm njëri nga elementet konstitutive të të drejtave të viktimës në teorinë bashkëkohore të cilat kërkojnë një angazhim më evident dhe të dukshëm të viktimës duke përfshirë këtu participimin por edhe mbrojtjen e tij. Sa i

⁷ Ligji për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008 dhe 150/2010)

⁸ Ligji për procedurë Penale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2010, 100/2012 dhe 142/2016)

përket terminologjisë, për mendimin tim termi “person i dëmtuar” që përdoret si në KPRMV ashtu edhe në Ligjin për Procedurë Penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në vazhdim LPPRMV), është shumë më i ngushtë se termi “viktimë” pasi që ai termin kufizohet vetëm tek personat që kanë vuajtur dëm material dhe është kryesisht i drejtuar në kompensimin material apo lukrativ të dëmit.

Edhe pse mbrojtja e të drejtave të njeriut është garantuar me Kushtetutën⁹ e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën janë vendosur bazat e të drejtave të njeriut dhe rregullat e përgjithshme për mbrojtjen e tyre, prap se prap në raportet të ndryshme hasim në potencime të ashpra ndaj thyerjeve dhe cënimeve bazë të të drejtave civile e qytetare edhe pse kjo garantohet nga vetë Kushtetuta, ligjet, Deklaratat dhe Konventat si më poshtë:

Neni 12 nga Kushteta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (i ndryshuar me amandamentin kushtetues III) përcakton se e liria e njeriut është e pacënueshme dhe ajo nuk mund ti kufizohet askujt, përveç me vendim të gjykatës dhe në procedurë të parapara me ligj. Për ligjshmërinë e privimit nga liria, pa vonesë, vendos gjykata. Pas ngritjes së akt-akuzës, paraburgimin e përcakton ose e vazhdon gjykata kompetente, ndërsa personi i arrestuar nën kushtet e parapara me ligj mund të lëshohet dhe mbrohet në liri. Ngjashëm, neni 5 i Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut parasheh që çdo njeri kako të drejtë në liri dhe siguri dhe se askush nuk mund të privohet nga liria, vetëm në bazë të ligjit.

Neni 13 i Kushtetutës së RMV parasheh që personi i akuzuar për veprë penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor. Në nenin 6, pika 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet që çdokush i cili është i akuzuar për veprë penale trajtohet si i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk dëshmohet në rrugë ligjore. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dyshimi për ate nëse dikush është fajtor duhet të i shkojë në favor të akuzuarit.

Neni 102 i Kushtetës së Maqedonisë së Veriut parasheh që shqyrtimet para gjykatave dhe shqiptimi i aktgjykimeve janë të hapura, ndërsa publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet e parapara me ligj. E drejta në gjykim publik garantohet edhe me nenin 6, pika 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut, si dhe me nenin 5 të Ligjit për procedurë penale.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 52/1991, 31/1998, 91/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009 dhe 49/2011)

Neni 12 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut parasheh që çdo person ka të drejtë në përfaqësues ligjorë/avokat në procedurë gjyqësore. Në nenin 6, pika c, të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut parashihet që çdokush ka të drejtë të mbrohet vetëm ose me ndihmën e mbrojtësit sipas zgjidhjes së tij, ndërsa nëse nuk posedon mjete për të paguar mbrojtës, të fitojë avokat zyrtarë pa pagesë kur këte e kërkojnë interesat e drejtësisë.

Neni 12 i Kushtetutës së RMV (i ndryshuar me amandamentin kushtetues XXV) përcakton që pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë autonome dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën. Llojet, kompetenca, themelimi, abrogimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura pranë tyre, rregullohen me ligj. Në nenin 6, pika 1 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një proces të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në qoftë se gjykatësi vendimin e tij e ka të bazuar para se ti shqyrtojë provat të cilat do mbështeste rezonimin e tij, ajo do të vlerësohet si e pa bazë dhe e palejueshme sipas nenit 6, pika 1 të Konventës.

Përveç akteve tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, të cilët në bazë të **Nenit 118 të Kushtetutës** janë pjesë e rendit të brendshëm ligjor, me rëndësi të veçantë janë aktet më poshtë:

- Marrëveshje të OKB, gjegjësisht: **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**, Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Qytetare dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Gazeta Zyrtare e Republikës Sociale Federale të Jugosllavisë, nr. 7/1971), ndërsa në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, zbatohet Manuali/Udhëzimet e Kuvendit të Përgjithshëm të OKB të vitit 1990 për skedarë të kompjuterizuar me të dhëna personale;

- Në lidhje me Marrëveshjet Evropiane, me rëndësi të veçantë është **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave të Njeriut dhe Liritë Themelore** (KEMDNJ) si dhe Konventa për Mbrojtjen e Personave në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (ECPIAPPD – Marrëveshja 108) si dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës (KE).

Në aktet e përmendura më lartë, të drejtat dhe liritë individuale janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme. Përcaktimet e gjera dhe të paqarta mund të sjellin dyshime të caktuara ose hamendje gjatë interpretimit të tyre, sepse dispozitat kanë tendencë vetëm të përcaktojnë drejtime të caktuara për zbatimin e standardeve ligjore. Gjatë kësaj, mund në mënyrë më të saktë të përshkruhet mënyra e realizimit dhe mbrojtjes me anë të dispozitave ligjore. Në vijim, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka miratuar më tepër akte dhe dispozita për rregullimin më të saktë. Mes tjerash, për veçanërisht relevante konsiderohen:

- **Kodi Penal**, me të cilën përcaktohen veprat e caktuara penale dhe parashikohen gjoba;
- **Kodi Qytetar**, me të cilin përcaktohen rregullat e përgjithshme për kompensim të dëmit, si dhe përfitimit të paligjshëm/palejuar;
- **Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDP)**, me të cilin përcaktohet se çfarë konsiderohet si e dhënë personale, kush mund të kontrollojë këto të dhëna, si dhe parandalim të përzierjes së paligjshme në privatësinë dhe dinjitetin e individit gjatë përpunimit të të dhënave personale;
- **Ligji për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik**, që përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurën e realizimit të së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik me të cilat disponojnë organet e drejtorisë shtetëror dhe organe tjera dhe institucione të themeluar me ligj;
- **Ligji për Medija**, që përcakton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave ligjor dhe individëve, si dhe interesin publik në fushën e medieeve. Mundësitë për të arritur në situata kritike që do të mund të shkaktohen me zbatimin e gjerë të së drejtës për shprehje të lirë zvogëlohen me përcaktim më të saktë të së drejtës për përmirësim dhe përgjigje të informacioneve të publikuar, të cilat ju garantohen personave në fjalë me Nenin 16 të Kushtetutës. Gjatë vendosjes për rastet individuale, zbatimi i rregullave shpeshherë plotësohet me praktikë gjyqësore. Në këto raste, me rëndësi të veçantë është praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ), që interpreton dhe zbaton Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNJ).

1.2.1 E drejta për përfaqësim dhe mbrojtje

Të drejtën e mbrojtësit parimisht e proklamojnë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare duke garantuar të drejtën që i akuzuari tëp mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit sipas

zgjedhjes së vet (neni 14 i PNDCP; neni 6, paragrafi 3 nga KEDNJ) që i mundëson të akuzuarit liri të plotë që të vendosë për atë se si do të mbrohet. E drejta për mbrojtje është kategori kushtetuese e në përputhje me nenin 12 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut kjo është zgjeruar edhe në procedurën policore.

E drejta është konkretizuar në shumë dispozita të LPP duke përfshira edhe të atilla të cilat, në rastet kur të akuzuarit nuk i tregohet për të drejtën e mbrojtësit, parashihen sanksione të ashpra procesuese që nënkuptojnë ndalim dhënies së vendimit gjyqësor të mbështetur në deklaratën e dhënë (neni 218 paragrafi 10 i LPP). I akuzuari mund të mbrohet vetë dhe sipas rregullit, ai vendos vetë se ado të marrë dhe cilin do ta marrë për mbrojtës. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se kjo e drejtë është absolute sepse i akuzuari për mbrojtës mund të zgjedhë vetëm ndonjë avokat kurse me ligj rregullohet se në cilat raste i akuzuari duhet patjetër të ketë mbrojtës, të cilin e cakton gjykata në rast se vetë i akuzuari nuk e zgjedh.

Kompetenca e gjykatës është kompleks i kualifikimeve të cilat kanë të bëjnë me relacionin e gjykatësit ndaj punës, kurse në thelb qëndron kujdesi për kompetencën mbi lëndën, pavarësi dhe paanësi gjatë vendimeve.

Kushtetuta dhe Ligji për gjykatat përmbajnë norma juridike që garantojnë parimin kushtetues për pavarësi dhe mëvetësi të gjykatave. Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, neni 98, pushtetin gjyqësor e zbatojnë gjykatat, kurse kompetencat, llojet, themelimin, ndërprerjen, organizimin dhe përbërjen e gjykatave, si dhe qasjen ndaj tyre e rregullon ligji. Sipas kësaj, kompetencën për të gjykuar, gjykatësi e merr sipas Ligjit për Gjykatat. Në Ligjin për gjykatat, posaçërisht e paraparë është që gjykatat të jenë organe shtetërore të pavarura dhe të mëvetësishme të cilat gjykojnë në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën, sigurojnë zbatimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Edhe krahas faktit se parimi për ndarjen e qeverisjes në mënyrë formale pranohet, kurse tekstet ligjore japin garanca të përgjithshme për pavarësinë e gjykatave, në praktikë këto garancione mbeten pa rëndësi të veçantë, për shkak të mangësive të mekanizmave për realizimin e tyre. Normat juridike relativisht mirë të përpunuara me të vërtetë në aspektin formalo juridik respektohen, mirëpo ka hapësirë të mjaftueshme për ndikim nga jashtë. Gjyqësia si tërësi, ende pjesërisht trajtohet si pjesë e Administratës shtetërore. Kontrolli financiar dhe formimi i të ardhurave të gjykatave dhe buxheti i tyre është i përqëndruar tek organet ekzekutive, në radhë të

parë tek ministrinë e resorit. Prej këtu, projekti për buxhet të veçantë gjyqësor paraqet hap të rëndësishëm për pavarësi thelbësore të gjyqësisë.

Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e qasjes deri te avokati, e cila do të hyjë në fuqi më 27 nëntor 2016, është Direktiva e tretë e miratuar në fushën e të drejtës procesuale penale, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës. Përveç asaj që garanton të drejtën e qasjes deri te avokati, Direktiva ka të bëjë edhe me të drejtën e lajmërimit të personit tjetër për privim nga liria dhe komunikimi me atë person, si e drejtë e lajmërimit dhe komunikimit me përfaqësitë diplomatike konsullore gjatë kohës së privimit nga liria (neni 1).

Në parathënien e Direktivës thuhet se ajo lidhet me mbindërtimin e neneve 3 (ndalim të torturës), 5 (të drejtës së lirisë dhe sigurisë), 6 (të drejtës së procedurës të drejtë gjyqësore) dhe 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) të KEDNj-së. Direktiva 2013/48/BE i referohet edhe Direktivës 2012/13/BE për të drejtën e informimit në procedurë penale e cila, siç është përshkruar më parë, u mundëson të dyshuarve dhe të akuzuarve të informohen në kohë për të drejtën e qasjes deri te avokati, si dhe personave të arrestuar apo të paraburgosur t'u sigurohet Letër e të Drejtave e cila përmban informacion për të drejtën e qasjes deri te avokati.

Direktiva, u referohet gjithashtu edhe Udhëzimeve të Këshillit të Evropës për drejtësi sipas masës së fëmijëve të vitit 2010, duke i promovuar të drejtat e fëmijëve. Direktiva ka të bëjë me personat e akuzuar dhe të dyshuar në procedurën penale, zbatohet në momentin kur personi nga autoritetet është informuar, sipas detyrës zyrtare apo në ndonjë mënyrë tjetër, se është i dyshuar ose se akuzohet për kryerjen e veprës penale, pa marrë parasysh se a është privuar nga liria ai person. Direktiva zbatohet deri në përfundim të procedurës. Me përfundimin e procedurës nënkuptohet vendimi përfundimtar lidhur me çështjen se a e ka kryer veprën, atje ku kjo është e zbatueshme, shqiptim i dënimit dhe zgjidhje sipas ankesës. Direktiva zbatohet nën kushte të njëjtat edhe ndaj personave të cilët nuk janë të dyshuar apo të akuzuar, por të cilët gjatë hetimit nga ana e policisë do të marrin statusin e personave të dyshuar apo të akuzuar (neni 2 (1) (3)).

E drejta e qasjes deri te avokati - Autoritetet duhet të sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar të kenë të drejtën e qasjes tek avokati në momentin dhe në mënyrë që do t'u mundësojë personave të praktikojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, në mënyrë praktike dhe efektive. E drejta duhet të sigurohet pa shtyrje të panevojshme. Personat e dyshuar dhe të

akuzuar duhet të kenë qasje tek avokati në një prej këtyre rasteve, që në atë kohë do të jetë më i hershëm:

- para marrjes në pyetje nga policia ose organi gjyqësor; –
- pas përfundimit të hetimit ose procedurës së grumbullimit të provave nga organet

hetimore;

- pa shtyrje të panevojshme pas privimit nga liria; dhe
- kur ata thirren që të paraqiten në gjykatën që ka kompetencë penale, në një afat të

arsyeshëm para se ato të paraqiten në gjykatë.

Për realizimin e suksesshëm të së drejtës së qasjes tek avokati, autoritetet për personat e dyshuar dhe të akuzuar duhet të sigurojnë:

- të drejtën të takohen personalisht dhe të komunikojnë me avokatin i cili i përfaqëson, duke e përfshirë edhe marrjen në pyetje paraprake të policisë ose organit tjetër gjyqësor;
- të drejtën që avokati i tyre të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në mënyrë efektive gjatë marrjes në pyetje.

Pjesëmarrja të ketë karakter i cili nuk do të jetë në dëm të shfrytëzimit efektiv të kësaj të drejte. Në rastet në të cilat avokati merr pjesë në marrjen në pyetje, pjesëmarrja e tillë duhet të evidentohet; dhe

- të drejtën që avokati i tyre të marrë pjesë gjatë procedurës hetimore ose procedurës tjetër të grumbullimit të provave, në rast kur u lejohet të jenë të pranishëm gjatë këtyre procedurave, e veçanërisht gjatë:

- identifikimit të personave ose sendeve;
- ballafaqimeve; dhe
- rikonstruksionit të ngjarjeve.

Përrjashtime nga këto rregulla janë të mundshme vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe gjatë procedurës hetimore paraprake, përkatësisht procedurës hetimore vetëm nëse këto përrjashtime janë të arsyeshme në aspekt të rrethanave konkrete të rastit, bazuar në një nga këto arsye relevante:

- atje ku ekziston nevojë e domosdoshme për parandalimin e kërcënimit serioz të jetës, lirisë ose integritetit fizik të ndonjë personi; dhe

– atje ku ndërrmarrja e masave urgjente nga organet hetimore është me rëndësi vendimtare për parandalimin e rrezikut të konsiderueshëm të procedurës penale.

Direktiva e garanton edhe besueshmërinë e komunikimit midis personave të dyshuar dhe të akuzuar dhe avokatit të tyre. Komunikimi minimum duhet të përfshijë takime, korrespondencë dhe biseda telefonike. E drejta e qasjes deri te avokati përfshihet në nenin 1-4 të Direktivës

E drejta për përkthyes për të akuzuarin i cili nuk e kupton gjuhën është standard i pakontestueshëm në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i akceptuar edhe në të drejtën krahasuese, si e drejtë e çdo personi të privuar nga liria ose të akuzuar për vepër penale, tek ne e përhapur mbi të gjithë pjesëmarrësit në procedurë. Standardi ndërkombëtar nuk nënkupton të drejtën që personi të shprehet në gjuhën që e zgjedh vetë, nëse ai ose mbrojtësi i tij nuk njohin mirë atë gjuhë (që është një çështje faktike).

Në procedurën penale nënkuptohet ndihma e përkthyesit që të mundësojë të kuptuarit e tërë asaj që e theksojnë prokuroria, dëshmitarët dhe ekspertët, por e drejta për ndihmë falas nga përkthyesi nuk është kufizuar në shqyrtimin gojor në gjykatë. Kjo krahas deklaratave ka të bëjë edhe me të gjitha dokumentet që i akuzuari ka nevojë t'i kuptojë, me qëllim që të ketë gjykim të drejtë. Garancia mbulon edhe procedurën e mëparshme, edhe përkthimin e dokumenteve siç janë akti i prokurorisë etj¹⁰.

Megjithatë, sipas Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, e drejta nga neni 6 paragrafi 3 respektivisht nga konventa evropiane *nuk shkon aq larg që të kërkojë përkthim me shkrim të çdo dëshmie me shkrim ose akt zyrtar në procedurë*. Ndihma e përkthyesit në këtë kuptim, duhet të jetë e tillë që t'i mundësojë të akuzuarit të ketë njohuri për rastin kundër tij dhe të mbrohet në mënyrë që para gjykatës të mund ta nxjerrë versionin e tij për ndodhitë. E drejta më tutje nënkupton përkthimin e deklaratave të dëshmitarëve në interes të tij.

Obligimi i autoriteteve kompetente shtetërore nuk kufizohet vetëm me caktimin e përkthyesit, por nënkupton edhe kontroll të arsyeshëm mbi *saktësinë e përkthimit*, veçanërisht nëse paraqitet nevoja për këtë. Në këtë drejtim mund të kërkohet edhe ndërrimi i përkthyesit.

Në përputhje me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ, LPP fillimisht parasheh që çdo person i thirrur, arrestuar ose i privuar nga liria menjëherë të njoftohen në gjuhën që e kupton për arsyet e thirrjes, arrestimit ose privimit nga liria si dhe për çdo akuzë penale kundër tij dhe dhe të drejtave të tij (neni3). Çdo i akuzuar ka të drejtë të jetë i informuar menjëherë, në gjuhën që e kupton dhe hollësisht për veprat për të cilat akuzohet dhe për dëshmitë kundër tij (neni 4 paragrafi 4 alineja

¹⁰ Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997)

1). Ajo që nuk duhet haruar është fakti se në përputhje me praktikën e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, harxhimet për përkthim i mbulon buxheti edhe të për të gjithë, e jo vetëm për të akuzuarit që nuk e njohin gjuhën. Përveç kësaj shkeljet e dispozitave të gjuhës nuk janë më shkelje absolute të procedurës, por mund të paraqesin vetëm shkelje relative, nga aspekti i shkeljes së të drejtave në shqyrtimin kryesor.

Sipas LPP, pjestar i ndonjë nacionaliteti që është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut në procedurën penale ka të drejtë të përdorë gjuhën e nacionalitetit të cilit i përket. Gjykata këtij personi i siguron përkthyes falas. Palët tjera, dëshmitarët dhe pjesëmarrës në procedurën në gjykatë kanë të drejtë për ndihmë falas¹¹ nga përkthyesi, nëse nuk kuptojnë apo flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Kjo është në përputhje me nenin 6 (3) d nga konventa evropiane për të drejtat e njeriut.

Poashtu, në këtë segment vlen të poenohet edhe **Parimi i barazisë procedurale**, që është një element kyç i konceptit për gjykim të drejtë. Edhe pse nuk haset në mënyrë të prerë në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, besohet se ai paraqet një parim të përgjithshëm juridik. Në Evropë, koncepti i cili qëndron prapa kësaj shprehjeje, shfaqet *si parim kundërrthëniesh*. Ky është njëri prej parimeve themelore të procedurës penale por thelbësisht përkufizohet nga is ashtuquajtur i parim hetimor (roli aktiv i gjykatës) (Miers, 1992).

Problemi i sigurimit të barazisë ndërmjet palëve në sistemin tonë është i një natyre tjetër, që është plotësisht e kuptueshme, ngase sistemi i përzier me rol aktiv i gjykatës, sipas karakterit të vet na inklinon kah parimi i barazisë ndërmjet palëve. Në të vërtetë, për përcaktimin e të vërtetës sipas detyrimit zyrtar është e ngarkuar, pik së pari, gjykata kurse palët, më pak ose më shumë, vetëm i ndihmojnë në këtë. Me këtë rast, njëri prej problemeve kryesore është fakti që gjykatësi është hollësisht i njoftuar me shkresat e organeve të ndjekjes, bile edhe me dëshmitë që formalisht nuk janë nxjerrë në gjykatë (Miers, 1992).

Në praktikë prokuroria dhe gjykata bashkëpunojnë shumë më ngusht se në sistemet akuzatore, thjesht për arsye se në thelb ata kanë hipoteza dhe interesa të afërta nisëse. Ndonëse nga pikëpamja teorike kjo nuk luan rol të rëndësishëm - sepse gjykata aktgjykimin e vet mund ta

¹¹ Në rastin Luedicke, Belkacem dhe Koc kundër Republikës Federale të Gjermanisë, gjykata ka vendosur se dispozita për ndihmë falas për përkthyes ndalon që t'i urdhërohet të akuzuarit që të paguajë për harxhimet e përkthyesit dhe se kjo dispozitë i mbulon edhe ato dokumente dhe deklarata gjatë procedurës që vendosen kundër tij, që është e nevojshme ai t'i kuptojë për të pasur një gjykim të drejtë.

mbështesë vetëm në dëshmitë e paraqitura drejtpërdrejtë në shqyrtim gojor dhe kontradiktor – efekti i tërthortë nga njohja e dosjes nga procedura paraprake, mund të ketë ndikim të dëmshëm në pozitën e të akuzuarit. Ndërkaq, problemi me ekspertët është zgjidhur më ndryshe ashtu që ata i cakton gjykata dhe ata llogaritet si neutralë dhe objektivë.

Së këndejmi, mbrojtja ballafaqohet me vështirësi kur duhet të kontestohen konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të këtillë zyrtarë, të cilët gëzojnë një respekt të caktuar që shkon me vetë pozitën e tyre. Kjo siguron një pavarësi parimore të ekspertëve por mund të jetë një problem i madh për mbrojtjen atëherë kur ekspertizat në fakt janë në favor të akuzës. Pikërisht për këtë, ka rëndësi të madhe qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, e cila vë në pah se atëherë akuzat mbështetet në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të këtillë “neutral” gjyqësor, për qëllimet e nenit 6 të Konventës, ata trajtohen si “dëshmitarë kundër të akuzuarit”, që mbrojtjes ia jep të drejtën që t’i sigurohet prania dhe dëgjimi i ekspertëve në favor të saj. Është një pyetje më delikate se kush do t’i mbulojë shpenzimet për këta ekspertë.

Sido që të jetë, ideja për caktimin e ekspertëve zyrtarë si persona të shkathtë nga ana e gjykatës, edhe më tutje llogaritet si e pranueshme përderisa garantohen standarse të larta sa i përket ekspertizës së tyre. Sido që të jetë, mbrojtja duhet të ketë mundësi reale që ti kontestojë konstatimet dhe mendimet e ekspertëve të caktuar nga gjykata, që jo gjithëherë garantohet në procedurat tona gjyqësore.

Kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes është njëra prej të drejtave minimale për çdo të akuzuar nga paragrafi 2 i nenit 4 të LPN. Kohë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes i lehet të akuzuarit gjatë zgjatjes së tërë procedurës, por vemendje e veçantë i kushtohet përgatitjes për shqyrtimin kryesor (thirja të akuzuarit duhet t’i dorëzohet ashtu që prej dorëzimit të thirrjes deri në ditën e mbajtjes së shqyrtimit kryesor të mbetet një kohë e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, e të paktën 8 ditë, përveç në rastet e procedurës së shkurtuar, për çka është caktuar një periudhë prej 3 ditësh). I akuzuari i cili thirrjen për shqyrtimin kryesor nuk e ka pranuar në kohë, nuk është i obliguar të paraqitet kurse mosshkuarja e tij nuk tërheq kurrfarë sanksionesh. Më tutje, për shkak të përgatitjes së mbrojtjes, gjykata mund ta ndërpresë shqyrtimin nëse akuzuesi gjatë shqyrtimit kryesor gojarisht ndryshon akuzën (neni 329 paragrafi 2 të LPP) apo parashtron akuzë për vepër penale të kryer ose zbuluar gjatë shqyrtimit kryesor (neni 330 paragrafi 2 të LPP).

Këqyrja e akteve. Në ligjin e vitit 1997, të drejtat e mbrojtjes janë forcuar me eliminimin e më tepër kufizimeve që kanë të bëjnë me këqyrjen e mbrojtjes së akteve dhe kontrollin e komunikimit mes mbrojtësit dhe të akuzuarit që gjendet në paraburgim. Në të vërtetë, në të dyja rastet është eliminuar kushtëzimi i të drejtave të mbrojtjes me ekzaminimin paraprak të të akuzuarit, kurse mbrojtësi ka të drejtën që *t'i shryrtojë shkresat dhe lëndët që shërbejnë si dëshmi* që nga momenti kur është dorëzuar kërkesa për zhvillimin e procedurës penale, si dhe kur gjykatësi i hetimit para marrjes së vendimit për fillimin e hetimit do t'i kryejë veprimet e nevojshme hetimore (neni 69 i LPP). Ndërkaq, i akuzuari mund t'i analizojë aktet dhe lëndët që shërbejnë si dëshmi, atëherë kur ai do të merret në pyetje (neni 124, paragrafi 5 i LPP), që, gjithashtu, mund t'i nënshtrohet kritikës. Megjithatë, në rastet *Jespers dhe Kamasinski*, organet në Strazbur kanë vërejtur se qasja në aktet për këqyje të mbrojtësit të të akuzuarit i kënaq kërkesat e Konventës: Vetë i akuzuari nuk e gëzon të drejtën autonome që t'i analizojë aktet.

Në këtë mënyrë e drejta e këqyrjes së akteve në legjislativën e vendit i tejkalon kërkesat e vendosura në praktikën e organeve të Konventës, sepse ata nuk e njohin të drejtën e qasjes në aktet në fazën e hershme të procedurës. Kërkesat që të njihet një e drejtë e këtillë në fazat që i paraprijnë akuzës, Komisioni Evropian i hodhi poshtë në raste të shumta, duke u kënaqur me atë që i akuzuari e ka pasur të drejtën e këtillë pas ngritjes së aktakuzës.

Rregulla dhe zbulime të dëshmimeve. Për dallim nga këqyrja në aktet, duhet pranuar se tek ne nuk ekzistojnë standarde që do të mbështesnin rregullat e zbulimit nga ana e gjykatave dhe organeve të tjera shtetërore që arrin pjesë në procedurën dëshmuuese, posaçërisht atyre në favor të mbrojtjes. Në pajtim me raportin e Komisionit në rastin *Jespers kundër Belgjikës*¹², organet e ndjekjes dhe autoritetet hetimore janë të obliguar që ta zbulojnë materijalin që e posedojnë, nëse është e mundur mbrojtjes t'i ndihmojë në kuptim të asaj që është theksuar më lartë.

Në nenin 166 nga LPP në të vërtetë parashihet se “nëse gjykatësi hetuas para hetimit të kryer mendon se është në interes të mbrojtjes që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij të njihen me dëshmitë e rëndësishme të grumbulluara gjatë hetimit, do ti njoftojë se në afatin e caktuar mund ti analizojnë lëndët dhe aktet që kanë të bëjnë me ato dëshmi”. Megjithatë, e drejta dhe praktika e vendit nuk njihin rregulla që do ta obligonin *Prokurorinë* që t'ia zbulojë mbrojtjes njohuritë, përkatësisht dëshmitë që i posedon në favor të saj, edhe pse nuk duhet të lehet anësh obligimi ’

¹² <https://rm.coe.int/handbook-3/16806fc13a>

tyre për objektivitet (me vëmendje të njëjtë t'i shqyrtojnë dhe përcaktojnë edhe faktet që e ngarkojnë të akuzuarin por edhe ata që janë në favor të tij nga neni 14, paragrafi 2 të LPP).

E drejta e ekzaminimit të dëshmitarëve. Në përputhje me neni 6, paragrafi 3 (g) të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, çdo person i akuzuar për vepër penale ka të drejtë që t'i dëgjojë ose të kërkojë dëgjimin e dëshmitarëve kundër tij dhe t'i sigurohet prani dhe marrje në pyetje e dëshmitarëve në favor të tij. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut nisat nga konstatimi se është thelbësore që mbrojtjes t'i jepet mundësia t'i kontestojë të gjitha dëshmitë që janë paraqitur në gjykatë dhe në të cilat ajo e mbështet aktgjykimin e vet.

Në parim, të gjitha dëshmitë duhet të nxjerren në prani të të akuzuarit në shyrtrimin kryesor në gjykatë me mundësi për kundërshtim të argumenteve në shqyrtim kundërvënës. Përveç në rrethana të jashtzakonshme (që kërkojnë arsyetim të veçantë), dëshmitarët duhet të ndëgjojnë në prani të të akuzuarit në shqyrtimin kryesor, me çrast të dyja palët jo vetëm që do të mund ti paraqesin argumentet e veta por ky shyrtrim edhe për shkak të nënshtimit të vetë kontrollit të opinjonit ofron garanci të qarta për një procedurë të drejtë (Miers, 1992).

Sido që të jetë, kjo megjithatë "nuk do të thotë se që të shfrytëzohen si dëshmi deklaratat e dëshmitarëve duhet gjithmonë ata të jepen në shqyrtimin publik në gjykatë. Përdorimi si dëshmi i deklaratave të marra në procedurën paraprake, vetëvetiu nuk llogaritet se është në kundërshtim me Konventën Evropiane.", "me kusht të respektohen të drejtat e mbrojtjes. Sipas rregullës, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit ti jepet rast adekuat dhe i duhur që ti kontestojë dhe t'i dëgjojë dëshmitarët kundër tij, qoftë në kohën kur dëshmitari e ka dhënë deklaratën ose në ndonjë fazë të më vonshme të procedurës, poqese kjo dëshmi është vendimtare".

KAPITULLI II

KONCEPTI I AVOKATISË DHE GJENDJA

AKTUALE

II. KONCEPTI I INSTITUTIT TË AVOKATISË DHE GJENDJA AKTUALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

2.1 Profesionin e avokatit dhe roli i tij në shoqëri, në një këndvështrim historik

Kur flasim për rolin e avokatit në shoqëri, kemi parasysh se ai si profesion zë fill qysh nga lashtësia, fillimisht në Athinë dhe më pas në Romën e Lashtë. Në Athinë avokatë konsideroheshin oratorët (orators), të cilët mund t'i jepnin këshilla ligjore një miku të tyre pa pasur të drejtë që t'i kërkonin atij paraprakisht apo në fund të punës një shpërblim në të holla, ashtu siç veprohet sot në profesionin e lirë të avokatit.

Ndërsa në Romën e Lashtë, rreth vitit 204 Përpara Krishtit, ashtu si dhe në Athinë, avokatë quheshin ata të cilët ishin trajnuar në retorikë (rhetoric). Oratorët mund të jepnin edhe këshilla ligjore. Me kalimin e kohës prej tyre lindën edhe të ashtuquajturit “këshilltarë ligjorë” (iuris consulti), të cilët e ushtronin profesionin jo si një mënyrë jetese, por si një hobi. Në Romën Perandorake profesioni i avokatit filloi të merrte zhvillim të madh, duke hyrë si një pjesë e rëndësishme e jetës tregtare (qarkullimit juridik) që zhvillohej në këtë periudhë (Ross, 2007).

Me zhvillimin e marrëdhënieve tregtare njohu zhvillim edhe profesioni i avokatit. Në Perandorinë Bizantine profesionin e avokatit e gjejmë jo vetëm më të zhvilluar, por edhe më të organizuar. Duke cituar juristin e njohur Fritz Schulz¹³ konstatojmë se, në shekullin e katërt gjërat kishin ndryshuar në Perandorinë lindore ku “avokatët tani ishin me të vërtetë profesionistë”.

Nga folja latine *advoco* e cila do të thotë me thirr në ndihmë, ka buruar edhe emërtimi *advocatus*, i cili në vetvete bashkon në mënyrë thelbësore kuptimin e nocioneve mbrojtës, përfaqësues juridik dhe avokat (Ross, 2007).

Historia e njerëzimit lidhur me lirit dhe të drejtat e tyre do të ishte e mangët dhe e pakuptueshme pa ekzistimin e institucionit mbrojtje. Kur kemi parasysh pashmangshmërinë e mundësisë së konfliktit të individit me rrethin social të tij, i cili rreth gjithmonë ka qenë i rrethuar me ndonjë lloj pushteti, pavarësisht nga stadet e zhvillimit të njerëzimit. Institucioni i mbrojtjes

¹³ Fritz Schulz (16 Qershor 1879 – 12 Nëntor 1957), jurist gjerman dhe një historian i së drejtës, një prej doktrinarëve më të rëndësishëm në të drejtën civile (Roman Law) në shekullin e 20-të. Emigroi në Angli për shkak të origjinës së tij hebraike dhe të përndjekjes nga nazistët gjermanë

lindi nga përpjekja për të mundësuar një pozitë të barabartë të njeriut përpara fuqisë të pushtetit politik (Evans, 2004).

Në shoqëritë primitive ka ekzistuar mbrojtje e paorganizuar, në rastet kur ndonjëri nga pjesëtarët e grupit ka bërë ndonjë gabim, kanë dalë anëtarë të caktuar të grupit për të mbrojtur interesin e personit që ka gabuar përpara gjykimit të bashkësisë. Megjithatë, kjo nuk llogaritet si zanafilla e funksionit mbrojtje, sepse ato persona që kanë marrë këtë rol, në të njëjtën kohë kanë qenë edhe gjykatësit e tij. Në kohën e ligji të Hamorabit kanë ekzistuar njerëz që kanë ushtruar funksionin e përfaqësimit, mirëpo këto këtë punë nuk e kanë ushtruar në mënyrë profesionale as që ky veprim ka pasur karakter obligues.

Në Kinë 500 vjet para erës sonë i ashtuquajhuri Tang Hsis në mënyrë të suksesshme e mbrojt një bashkëqytetarë të tij para gjykatës dhe për këtë ai mbeti në kujtesën e analeve të asaj kohe. Shenjat apo fillesat e vërteta të avokaturës gjenden në Greqinë antike. Lindja e gjykatave të përhershme në shoqërinë antike Greke gjeneroi nevojën e përfaqësimit para gjyqit. Mbrojtja në fillet e saja nuk ka qenë profesionale dhe shërbimet e saja kanë qenë pa pagesë. Mirëpo, me kalimin e kohës ky shërbim kaloi në zanat, nga i cili sigurohej ekzistenca e këtyre personave. Në fillim, avokatët antik përpilonin mbrojtjen, të cilën personat e akuzuar e lexonin vetë para gjykatës, ku pak më vonë de facto morën mbi vete edhe funksionin e folësit dhe nga ky funksion morën emërtimin si orator.

Kulminacionin e vetë të zhvillimit avokatura si profesion e arriti gjatë shtetit Romak. Në fillim këtë funksion, si përfaqësues të të akuzuarit, e kishin priftërinjt, më pas personat në aspekt normativ kategorizohen me nocionin *vindex*, që pas kësaj në skenën juridike romake kanë hyrë përfaqësuesit juridik profesional, të cilët mund t'i llogarisim mbrojtës në kuptimin e tanishëm të fjalës (Evans, 2004).

Profesioni i avokatisë ka qenë i çmuar edhe në epokën e Perandorisë Bizantine. Avokat (sinigoros) ka qenë anëtarë i çmuar shoqërisë bizantine gjersa rangu i të qenit avokat përfaqësonte shtresë të lartë në Konstantinopojë. Shteti ka pasur kontroll të fortë mbi profesionin mbrojtës, jashtëzakonisht në shkollimin e tyre dhe kontroll rigid në të hyrat financiare gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre.

Shkëlqimi dhe lavdia e avokatëve antik u përballë gjatë kohës së mesjetës, me tentimin e kishës për dominim në të gjitha segmentet e jetës së shoqërisë. Me karakteristikat e veta që posedonte procedura e inkuizicionit në masë të madhe e injoronte rolin e mbrojtësit në një proces penal. Në periudhën nga shekulli i V deri në shekullin XII procedura penale kryesisht bazohej mbi pohimin e të pandehurit, si dhe konstatimin e të vërtetës formale në bazë të provave irracionale. Ndhëm juridike kanë ofruar priftërinjtë si të vetmit persona të arsimuar. Priftërinjtë nuk kanë ushtruar vetëm funksionin e mbrojtjes, por edhe të gjykatësve si në gjykatën kishtare, ashtu edhe në atë shtetërore. Gjatë fundit të mesjetës, pasoi ndryshimi në ndërgjegjen shoqërore – juridike, dhe nga kjo arsye pushtetarët kishtar ua ndaluan priftërinjve që të merren me përfaqësimin juridik. Kjo ndalesë nënkuptohet si kthim te profesionalizmi i nocionit mbrojtës.

Me rënien e Perandorisë së Perëndimit dhe ardhjen e periudhës së mesjetës së errët, në kontinentin evropian edhe profesioni i avokatit, ashtu si dhe shumë aktivitete të tjera të jetës, humbi përkohësisht rolin e tij. “Dinjiteti” i avokatit u arrit të fitohej sërish rreth viteve 1231, falë përpjekjeve të kishës dhe të shtetit për ta ringritur atë me rregulla më të qarta. Me kalimin e viteve, profesioni i avokatit filloi të merrte formë më të qartë dhe të bazohej në rregulla më të plota për organizimin dhe funksionimin e tij. Avokatët u ndanë në dy grupe të mëdha, në ata që e ushtronin profesionin sipas sistemit të civil law dhe ata që e ushtronin profesionin sipas sistemit të common law. Por, pavarësisht kësaj ndarjeje në dy sisteme të së drejtës, avokatët kishin të njëjtën natyrë pune, atë të ndihmës juridike që u jepnin individëve apo tregtarëve për çështje të ndryshme. Kështu, sipas ndarjes në këto dy sisteme të mëdha, vërehet se për avokatët në sistemin civil law është pothuajse e pamundur të ndryshojnë karrierën dhe të emërohen si gjyqtarë, me përjashtime në disa vende të këtij sistemi, përfshi këtu edhe sistemin e së drejtës në vendin tonë.

Në periudhën e lindjes së shteteve bashkëkohore, përfaqësuesit e ideve çlirimtare dhe përparimtare mendonin se avokatit duhet t’i mundësohet sa më shumë qasje në procedurë penale. Është tentuar në Francë pas vitit 1789 dhe në Rusi pas vitit 1917, që avokatura të hiqet dhe të zëvendësohet me një zyrë të administratës publike, të cilën do ta ushtronte organ i veçantë i administratës shtetërore, që të mos mbetet si profesion i pavarur dhe i lirë. Këto tentativa në asnjë vend deri më sot nuk kanë pasur sukses.

Ndërsa, në sistemin common law nuk është e pazakontë që për t’u emëruar gjyqtar kërkohet që të kesh punuar disa vite në praktikë si avokat. E theksuam këtë fakt për të nxjerrë në

pah rëndësinë e profesionit të avokatit në të dyja sistemet, por edhe vlerën e “shtuar” që ai merr sidomos në sistemin common law (Evans, 2004).

Profesioni i avokatit është kthyer sot në kohët moderne në një nga profesionet më të kërkuara, pasi nuk ka hapësirë të jetës ku avokati nuk lë gjurmët e tij. Për t’u bërë avokat kërkohet që të plotësohen disa kritere, të cilat në vende të ndryshme janë të ndryshme.

2.2 Përshkrimi i profesionit

Si avokat ju keni nevojë të posedoni një mendje analitike, qasje logjike dhe një nivel të lartë vëmendjeje për detajet, pasi vetëm në këtë mënyrë keni për të pasur sukses në një nga karrierat më të kërkuara dhe të dobishme në botë (Ross, 2007).

Avokati është specialisti që këshillon dhe përfaqëson individë dhe organizata para një gjykatësi ose para palëve të tjera. Ata janë burim i pavarur që mund të organizojnë këshilla ligjore ose mund të këshillojnë klientët në lidhje me rastin që mund të kenë. Si avokat do të të duhet që të mbrosh rastin në emër të klientit tuaj duke parashtruar prova që tregojnë pafajësinë e klientit që përfaqësoni (Evans, 2004).

Shumica e avokatëve janë zakonisht të vetëpunësuar, ndërsa të tjerë punojnë në departamente ose agjenci qeveritare. Gjithnjë e më shumë është duke u rritur numri i avokatëve të punësuar pranë organizatave private dhe atyre publike, përfshirë këtu edhe organizatat e bamirësisë. Nëse jeni të vetëpunësuar atëherë do të punoni në zyrën tuaj i vetëm ose me kolegë të tjerë, pra do të krijoni një studio ligjore me disa avokatë. Si avokat do ju duhet që të specializoheni në fusha të caktuara të ligjit si:

- e drejtë civile
- e drejtë penale
- ligji për familjen dhe shërbimet sociale
- ligji për sportin
- e drejtë biznesi
- e drejta e pronësisë, etj.

Profilizimet:

- Avokat
- Avokat populli

- Jurist
- Jurist për administratë publike
- Prokuror
- Prokuror i përgjithshëm
- Avokat shteti
- Këshilltar juridik
- Jurist për shoqëritë tregtare
- Specialistë të tjerë ligjor
- Specialistë ligjorë dhe profesione që lidhen me to
- Sekretar ligjor

Aftësitë e një avokati (Ross, 2007):

- ✓ aftësi akademike (sidomos aftësi kërkimore)
- ✓ aftësi ligjore dhe komerciale
- ✓ shkathtësi në fushën e shkruar dhe atë gojore
- ✓ shkathtësi në avokatim
- ✓ aftësi shumë të mira për menaxhimin e njerëzve dhe projekteve
- ✓ aftësi të shkëlqyera në monitorimin e situatave, pra të qëndroni i qetë kur situata është e tensionuar ose ndodheni nën presion
- ✓ aftësi të mira në informatikë
- ✓ vetë-motivim dhe vetë-disiplinë
- ✓ përgjegjësi dhe integritet
- ✓ vendosmëri dhe qëndrueshmëri.

Përgjegjësitë:

Aktivitetet e punës varen nga një sërë faktorësh, duke përfshirë këtu edhe praktikën e punës. Megjithatë, përgjithësisht do të përfshihen në detyrat e mëposhtme (Ross, 2007):

- ✓ Do të merrni udhëzime nga klientët dhe avokatët e tjerë që ky i fundit mund të ketë punësuar
- ✓ Do të ju duhet të kuptoni dhe interpretoni ligjin
- ✓ Do të ju duhet të zotëroni dhe menaxhoni informatat ligjore (rastet)

- ✓ Do të ju duhet të ndërmerri hulumtime ligjore në pikat përkatëse të ligjit
- ✓ Do të ju duhet të shkruani opinione duke këshilloni avokatë dhe profesionistë të tjerë
- ✓ Do të ju duhet të përgatisni rastet për gjykatë, ku përfshihet mbajtja e konferencave për klientët dhe përgatitja e argumenteve ligjorë.
- ✓ Do të ju duhet të këshilloni klientët për çështjet e ligjit, provat dhe fuqinë që ka rasti i tyre (në momentin që ka të bëjë me një fenomen shoqëror)
- ✓ Do të përfaqësoni klientët në gjykatë
- ✓ Do të paraqisni argumente në gjykatë
- ✓ Do të ekzaminoni dhe analizoni dëshmitarët
- ✓ Do të përmbledhni arsyet pse gjykata duhet të mbështesë rastin e klientit që përfaqësoni
- ✓ Do të hartoni dokumente ligjore

Mirëpo nëse jeni avokat nuk është e thënë që të merreni vetëm më raste të ngjashme, ju keni të drejtën që të përfaqësoni klientë me problematika të ndryshme duke filluar nga këshillimet e martesave e deri tek vrasjet, psh. (Ross, 2007):

- puna e një avokati penal ka të ngjarë të përfshijë edhe këshillimin në gjykatë
- një avokat i së drejtës familjare mund të përfaqësojë klientët në gjykatë në një mosmarrëveshje ose rast divorci, por gjithashtu mund të përfshihet në ndërmjetësim, mënyrë kjo që mund të shmang nevojën për të shkuar në gjykatë
- avokatët që ushtrojnë profilin e të drejtës së biznesit janë përgjithësisht profesionistët më të paktë në numër, kjo për arsye se kalojnë më shumë kohë duke ndërmarrë punë hartuese dhe këshilluese, mirëpo ky specialist mund të merret me çështje gjyqësore të veçanta që nuk ka lidhje me të drejtën e biznesit.

2.3 Kodi etik dhe marrëdhëniet e avokatit

Kodi i Etikës së avokatëve të Maqedonisë së Veriut, të miratuar nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Republikës së maqedonisë së Veriut një sërë rregullash që avokatët menaxhojnë punën e tyre, dhe dispozitat e tyre që pasqyrojnë karakterin moral dhe divorc profesionale frymore. Detyrë e të gjithë avokatëve të kujdeset për zbatimin e tij të duhur, dhe kjo është në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës, e parimet e pranuar më parë dhe të zhvilluara të

etikës profesionale të avokatëve, si dhe rregullat e etikës profesionale për Bashkimin Evropian dhe Ndërkombëtar të Avokatëve.

Dështimi për të ndjekur rregullat e Kodit të përbëjë shkelje të disiplinës, me një vendim të Dhomës së përcaktuar nga afër shkeljet e praktikuar detyrë të ligjit dhe reputacionin e bar. Për shkelje të detyrës ose reputacionit të bar, në përputhje me dispozitat e advokatura në seksionin e quajtur "Përgjegjësia për shkeljen e detyrës ligjit dhe reputacionin e Tivarit," avokati mund të shqiptuar një nga masat e mëposhtme disiplinore, të tilla si: publik qortim, gjobë deri në dhjetë shumën e anëtarësisë vjetore dhomës dhe përfundimin e përkohshëm të së drejtës për të kryer aktivitetet ligjore për një periudhë prej një viti. Kundër vendimit për masën disiplinore, avokati mund të, brenda 8 ditëve nga marrja e vendimit për të apeluar në autoritetin e Odës së Avokatëve të Maqedonisë së Veriut dhe kundër vendimit përfundimtar të masës disiplinore ai mund të ngritë kontest administrativ para gjykata kompetente e përcaktuar me ligj.

Gjithashtu, neni 13 i Statutit të Shoqatës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përshkruan se organet e Odës janë: Kuvendi; Bordi i Drejtorëve; Bordi Mbikëqyrës; Prokurori disiplinor; Disiplinore Gjykata dhe Këshilli Apelit, dhe në përputhje me nenet 26 dhe 27 të Statutit, dhe se Prokurorit Disiplinor është organi që inicion dhe mbështet akuzat disiplinore kundër një anëtar i Dhomës së shkeljeve të kryera disiplinore, ndërsa Gjykata disiplinor është organi që vendos për akuzat për akuza disiplinore. Dhoma e Apelit vendos për ankesat kundër vendimeve të Gjykatës Disiplinore. Puna e të gjitha këtyre organeve është i rregulluar nga afër me Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore, dhe në pajtim me Ligjin mbi Avokaturën dhe Statutin e Dhomës. Në rishikimin e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve së pari do të shohim qëndrimin e avokatëve ndaj palës dhe rastit.

Raporti i avokatëve me palën dhe lëndën kërkon ato si ofruesit e ofruesve ligjore ndihmës dhe autoriteteve publike për të ofruar ndihmë juridike për të përfaqësuar ose mbrojtur klientët kur ata janë duke kërkuar për këtë qëllim. Avokatët duhet të refuzojë të japë ndihmë juridike apo autorizime publike për shkaqe të arsyeshme, të tilla si: mbingarkesë në operacion, shans të vogël të suksesit në këtë rast, paaftësia e partisë për të paguar shpenzimet dhe të shpërblejë ndërgjyqësit papërgjegjshme etj .. refuzimit për të japin ndihmë juridike në çështjet penale duhet të jetë i vlerësuar me kriteret e rrepta dhe kjo është e lejuar vetëm në raste të veçanta, për natyrën objektive dhe subjektive, të tilla si avokati Alzheimer, vonuara nga i pandehuri fund një mbrojtje mbi të njëjtën temë dhe si i pandehuri nuk duhet të lihet pa mbrojtje.

Nëse palët u kërkojnë avokatëve që t'i përfaqësojnë ato në kundërshtim me të vërtetën materiale të paraqitur, ata mund ta refuzojnë përfaqësimin. Në raste të tilla ata nuk duhet të marrin ndonjë gjë që mund të dëmtojë palën (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

Në rastin e klientëve të varfër të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë tarifën e avokatëve në shumën e plotë, ajo nuk mund të ndikojë në refuzimin për të dhënë ndihmë ligjore, pasi kjo është një detyrë tradicionale dhe i nderuar e profesionit ligjor. Ata mund ta refuzojë përfaqësimin, mbrojtjen ose ofrimin e ndihmës juridike nga të njëjtat arsye të vlefshme mund të refuzojë ndihmën juridike, por në qoftë se ata të shkaktojnë zbuluar pas marrjes subjektet në këtë rast Avokatët janë të detyruar partinë e tyre për të përfaqësuar deri në ju nuk keni ofruar një tjetër përfaqësues ligjor, por më së shumti brenda 30 ditëve. Nëse avokatët e pranojnë kryerjen e autoritetit publik, ofrimin e ndihmës juridike, përfaqësim ose mbrojtje, ata janë të detyruar që të mbetet besnik ndaj partisë së tyre dhe të përpiqen me të për të ndërtuar marrëdhënie të besimit (këtu Kujtoj fjalët e Alan Dershvic, i cili shkroi: "*Bibla paralajmëron kundër shërbente dy zotërinjve. Kështu, ndërsa Stanka juaj nuk është mjeshtri juaj, ju duhet të shërbejë vetëm atë ose të saj në një situatë të përfaqësimit të tyre*" (Dershvic, 2010), por ata kurrë nuk mund të identifikohen me atë, por duhet të për të qëndruar në kulmin e f një zyrë - një avokat ose një mbrojtës i partisë së tyre. Ata duhet me vetëdije të mbrojnë dhe mbrojnë partinë e tyre, duke përdorur të gjitha mjetet e nevojshme dhe të lejuara me ligj ose rregullore të tjera. Avokatët prej palës duhet të marrin të dhëna shteruese me ndonjë dëshmi, duke paralajmëruar atë se interesi i saj është avokati i tij për të përmbushur të gjitha faktet dhe të detyruar, çdo objekt që shkarkohet, me ndërgjegje të studiuar dhe për të dhe për të ata sillen dhe shprehin shprehimisht mendimin e tyre për rezultatin eventual të mosmarrëveshjes për palën.

Gjatë procedurës, ata janë të detyruar palën e tyre për të mësuar në lidhje me gjendjen aktuale të çështjes - nga ana faktike dhe ligjore dhe për të shmangur dorëzimin panevojshme ose duke i dhënë propozime të panevojshme, dhe të kërkojë të gjitha provat dhe faktet për t'u përqëndruar në numrin më të ulët të parashtresave. Në të njëjtën kohë, ata në çdo fazë të procedimit, me kërkesë të palës, janë të detyruar të sigurojnë të gjitha dokumentet origjinale dhe shkrimet e tjera (përveç koncepteve të tyre). Ajo do të jetë më shumë në marrjen e rastit, nëse është e mundur, avokatët të njoh partinë me shumën e shpenzimeve dhe shpërblimet për përfaqësim, pra duke ushtruar pushtetin publik. Në qoftë se bëhet fjalë për një palë që është në gjendje të dobët financiare, avokatët llogaritjes duhet të jenë në përputhje me mundësitë e

pagesës në të njëjtën ose dhënies me poshtë edhe nën normën minimale të lejueshme për punën e avokatëve dhe të klientëve mjaft të varfër nuk kërkojnë asnjë kompensim, duke pasur parasysh parimin e vjetër etike të avokatëve: *"Jo, për shkak të pamundësisë për të paguar avokat, duke lënë pa një avokat dhe ndihmë juridike të cilësisë"* (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

Gjatë përfaqësimit të palës së tyre, ata nuk duhet të pranojnë asnjë ofertë për të përfaqësuar palën kundërshtare, apo gjëra të tjera që janë në mosmarrëveshje dhe janë në kundërshtim me interesat e palëve gjatë mosmarrëveshjes. Gjithashtu avokatët nuk duhet të marrë autorizime publike ose përfaqësim apo mbrojtjes bashkë-palët ndërgjyqëse ose të pandehurit, nëse interesat e tyre të përbashkëta janë kundër. Në qoftë se një rast i tillë lindin gjatë përfaqësimit apo mbrojtjes, ata janë të detyruar të refuzojë përfaqësimin ose mbrojtjen e një partie.

Gjithashtu, avokatët në përgatitjen e çështjeve të dy anë juridike (kontratat, etj) janë të detyruar që me ndërgjegje të mbrojtur interesat e të dyja palëve, pavarësisht nga të cilat i pari kërkoji ndihmë ligjore dhe të cilën e paguan çmimin. Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me një marrëveshje të tillë, atëherë ata nuk duhet të paraqiten si përfaqësues të secilës palë. Avokatët nuk do të pranojnë autorizime publike, advokacisë, mbrojtjen ose të sigurojnë ndihmë tjetër ligjore për palët, kur ajo do të kishte qenë të mbingarkuara në masën që rasti mund ndërgjegje dhe tërësisht obrabotat. Vo rast shumë i zënë, ata duhet të partisë për t'iu referuar kolegët e tyre të tjerë të cilët kemi besim dhe të cilat ende kanë kohë të aftë për të pranuar palën.

Marrëdhënia ndërmjet avokatëve dhe palëve në aspektin e fshehtësisë profesionale kërkon që ata të mbajnë sekretin profesional, sepse gjithçka që palët do t'u besojnë avokatëve të tyre në lidhje me këshilla ligjore, avokim apo mbrojtje të kërkuar dhe gjithçka që avokatët vetë kanë mësuar për këtë çështje në një mënyrë tjetër, dhe ajo që është konfidenciale, është një sekret i avokatit profesionist. Detyrimi për të mbajtur një sekret profesional zbatohet ndaj të dhënave që ruajnë në arkivat e tyre (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

Avokatët janë të detyruar të mbajnë sekretin e avokatit profesional nën kontrollin e përgjegjësisë disiplinore ose penale. Ai trajtohet si një sekret gjatë mbrojtjes dhe advokimit, por edhe më vonë, për sa kohë që zbulimi i tij ndaj publikut mund të dëmtojë partinë. Gjithashtu, nëse avokatët që kanë mësuar disa informata kur përfaqësojnë një person juridik ose diçka që njihnin kur ishin anëtarë, ata nuk duhet ta përdorin atë në asnjë procedurë, në dëm të tyre.

Avokatët e dinë se çfarë kanë mësuar nga palët dhe që është sekret profesional, ata mund të zbulojnë vetëm kur vetë palët, pa dyshim, e lejojnë atë, nëse është në interes (e domosdoshme) për mbrojtjen, si dhe në rastet kur ajo ata vetë do të kërkojnë dhe marrin pëlqimin e Shoqatës së Avokatëve. Kur shqyrton një kërkesë të tillë, Dhoma do të vlerësojë të gjitha rrethanat e përhershme (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

Raporti i avokatëve me palën e kundërt kërkon që ato të pala e kundërt nuk panë armikun, por kundërshtari mesatare, e cila mund të jetë po aq i sigurt në të drejtën e tij, dhe pala që ata përfaqësojnë. Prandaj, qëndrimi i avokatëve në anën e kundërt duhet të jetë e saktë. Brenda kufijve të dispozitave ligjore, avokatët duhet të veprojnë me forcë dhe pa frikë. Ata duhet të shmangin çdo kontakt me palën tjetër pa dijeninë e partisë së tyre ose përfaqësuesit të palës kundërshtare. Avokatët mund të vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me palën kundërshtare ose përfaqësuesi i tij ose avokati, vetëm për duke u përpjekur për të zgjidhur në mënyrë paqësore mosmarrëveshjen dhe vetëm me propozim ose me njohurinë e partisë së tyre (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

Avokatët nuk duhet të shfrytëzojnë injorancën e palës kundërshtare, veçanërisht në qoftë se ajo nuk ka një avokat, duke ndihmuar për të arritur sukses të pajustificueshëm për partinë e tyre, dhe në qoftë se në një marrëdhënie miqësore me palën tjetër, ata duhet të njoftojë palën e tyre, edhe para se duke marrë çështjen për të hequr të gjitha dyshim për kryerjen e detyrave të pranuar (Kodeksi etik i avokatëve, 2011).

2.4 Gjendja aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Avokatura si një shërbim publik¹⁴ i pavarur në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekziston në vazhdimësi që nga viti 1945. Ligji ekzistues për Shoqatën e avokatëve u miratua në vitin 2002, por që atëherë është ndryshuar në masë të konsiderueshme nga disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë hequr një pjesë të dispozitave të Ligjit për Odën. Anëtarësia e Shoqatës së avokatëve regjistron më shumë se 2,500 avokatë aktivë dhe ekziston trendi i anëtarësimit në rritje për rreth 100 avokat në vit, kryesisht për shkak të pamundësisë për të absorbuar avokatët e rinj në sektorin komercial. Në vitin 2016, tarifatat ligjore u ndryshuan dhe

¹⁴ Ligji për avokaturë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 59/2002, 60/2006, 29/2007, 106/2008, 135/2011, 113/2012 dhe 148/2015)

çmimet u rritën dukshëm në mënyrë të konsiderueshme në GPL, si dhe u rritën shërbimet noteriale dhe ekzekutimin e detyruar¹⁵.

Në drejtim të forcimit të profesionit të avokatëve e cila mund t'i përgjigjet sektorit të reformuar të gjyqësisë, nevojitet një analizë gjithëpërfshirëse që do të zbulojë drejtimet themelore për reformën sistematike të profesionit të avokatëve, statutit, pozitës dhe kompetencave të Odës së Avokatëve. Drejtimet strategjike:

- Hapje e zyrave ligjore për ofrimin e ndihmës juridike falas në territorin e secilës gjykatë në Republikën e Maqedonisë nga ana e Odës së avokatëve.

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet MD-së dhe OA në lidhje me përmbajtjen dhe zbatimin praktik të taksave të avokatëve me qëllim të përmirësimit të qasjes në drejtësi në përputhje me objektivat e kësaj Strategjie.

- Analizë e pozitës ligjore ekzistuese dhe punës së profesionit të avokatëve dhe qasjes së saj në reforma në përputhje me reformat në segmente të tjera të sektorit të drejtësisë.

2.3.1 Cënimet e të drejtave themelore për qasje në avokat në procedurën penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Neni 12 i Kushtetutës përcakton se personi i thirrur, i arrestuar ose i paraburgosur ka të drejtë për një avokat në polici dhe procedurat gjyqësore. E drejta e qasjes në avokat (mbrojtës) në procedurën penale rregullohet nga Neni 71 LPP, i cili thotë se çdo person i dyshuar ose i akuzuar për një krim ka të drejtë të avokatit gjatë procedurës penale kundër tij, në bazë të analizës së Helsinkit Komisioni për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të botimit "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore në Republikën e Maqedonisë".

Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën e mbrojtësit gjatë tërë procedurës penale kundër tij "Të akuzuarit, para se testi i parë ose në një tjetër veprim për të cilin obligim i tillë është paraparë me këtë ligj, duhet të këshillohen të drejtën e tij të avokatit të zgjedhur prej tij me të cilët ju privatisht për të këshilluar dhe mbrojtësi mund të marrë pjesë në gjyqin e tij.

¹⁵ http://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjija%20i%20akciski%20plan_ALB-web.pdf

Në pajtim me nenin 78 të LPP-së, avokati është i autorizuar në favor të të pandehurit për të marrë të gjitha veprimet që i akuzuari mund të marrë. E drejta e qasjes në avokat është themeluar në Ligjin për Policinë, në nenin 34 të cilit thuhet se i pandehuri ka të drejtë për përfaqësim dhe këshillim me një avokat gjatë procedurës policore.

Përveç kësaj, neni 43 i Ligjit për Policinë parasheh që njoftimi formal duke i bërë thirrje qytetarëve, në mënyrë për të mbledhur informacionin e nevojshëm të nevojshme për kryerjen e punës policore do të përfshijë udhëzimin mbi të drejtën për një avokat në procedurën policore, neni 63 thuhet që në kryerjen e njohjes, përveç punonjësve të policisë që kryejnë këtë metodë dhe të dyshuarit mbi të cilin bëhet njohja, mund të jetë i pranishëm avokati i të dyshuarit.

Sipas nenit 206 të LPP-së, nëse i akuzuari nuk ka avokat ose nëse nuk mund ta kontaktojë, do t'i dorëzohet lista e avokatëve të detyrës, të përgatitur nga Shoqata e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nëse i akuzuari fillimisht nuk donte një këshillë, por më pas shprehu dëshirën për të marrë një mbrojtës, shqyrtimi do të ndërpritet dhe rifillohet kur i pandehuri merr një avokat me të cilin mund të këshillohet.

Sipas nenit 90 të Ligjit për Drejtësinë për Fëmijët¹⁶, mbrojtja e fëmijës në të gjitha fazat e procedimeve gjyqësore është e detyrueshme, ".

➤ **Shumica dërrmuese e të burgosurve nuk kanë qasje në një avokat**

Më tej në "Të drejtat gjyqësorit me bazë në Maqedoni", thekson se në bazë të Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës, të dhënat e të ndaluarve në stacionet e policisë që u vizituan në vitin 2010 duke folur për faktin se pjesa më e madhe e të burgosurve nuk kanë qasje në një avokat.

"Komiteti si shembull përmendi stacionin policor" Gazi Baba "(në të cilën qasje në një avokat ata ishin të dhënë vetëm 44 prej 752 të burgosurve, që është më pak se 6%). Ngjashëm ishte situata me stacionet policore "pazar gjerash të lira" dhe "Qendra" në Shkup.

Sipas zyrtarëve të zbatimit të ligjit i cili foli me anëtarët e Komitetit, qasje në një avokat është i aktivizuar zakonisht vetëm kur personi i arrestuar mund të paguajnë për përfaqësim.

➤ **Gjykatat nuk kontrollojnë gjithnjë nëse i pandehuri është financiarisht i aftë**

¹⁶ Ligji për drejtësinë e fëmijëve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/2013)

Në kuadër të projektit "Rrjeti 23"¹⁷, Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta", Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut shtoi, monitoroi zbatimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë në Gjykatën Themelore Shkup 1.

"Analizat kanë treguar se në 42 rastet e monitoruara, i pandehuri kishte avokatin e tij mbrojtës, ndërsa në dy raste ai u caktua avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Në katër raste, ose 7%, i pandehuri i parë nuk kishte mbrojtës, por procedura u zhvillua për krime për të cilat mbrojtja nuk është e detyrueshme.

Lidhur me mësimin e ndihmës juridike falas nga avokati, në 15 raste, i pandehuri u mësua për këtë të drejtë, dhe në dhjetë raste nuk u mësua.

Sipas hulumtimit në fjalë, numri i vogël i njerëzve të arsimuar në këtë të drejtë shpjen në përfundimin se gjykatat jo gjithmonë e kontrollojnë nëse i pandehuri është financiarisht i aftë të mbulojë shpenzimet e mbrojtjes.

Vëzhguesit vunë në dukje se në vetëm 53% të procedimeve, mbrojtësit ishin të përgatitur për cilësinë dhe nuk dhanë përshtypjen se nuk përfaqësonin siç duhet klientët e tyre, "thuhet në" Drejtësia dhe të Drejtat Themelore në Republikën e Maqedonisë".

Nga intervistat e bëra me avokatë nga institucionet e ndryshme, konkluzioni është se ata janë më shumë se puna e tyre nuk kanë përdorur mundësinë e nenit 58 b (3) të LPP, të burgosurit që janë dënuar me gjobë deri në 90 gjoba ditore ose 1,800 euro në denarë ose burgim deri në tre muaj për të aplikuar për ndërrim të dënimit me shërbim të komunitetit.

Çështja që shkakton një avokat përdorim të rrallë në stacionet policore të analizës për mbrojtje efektive në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 48% e të anketuarve thanë se të dyshuarit nuk janë informuar siç duhet në lidhje me të drejtën e avokatit, 18% tha se policia qëllimisht off nga manipulimi, kërcënime, etj, dhe 9% se qytetarët nuk kanë besim divorc.

I pyetur nëse ndihmuar policinë apo ndjekjen penale të të dyshuarve ose të pandehurve për të gjetur një avokat, 47% thanë disa herë, 29% - 24% gjithmonë - shpesh.

I pyetur nëse ka një skemë detyrë ose në plan të thërrasë një avokat në raste urgjente për të siguruar të drejtën e avokatit të personit të arrestuar, madje edhe kur ai person nuk mund të përballojë një avokat, 30% thanë se ekziston një listë e përgatitur, 23% nuk tha, por personi i jepet pasqyrë e regjistrimit të përgjithshëm / directory e avokatëve, 20% thanë se mbrojtësi i

¹⁷ https://epi.org.mk/docs/Mreza23_izvestaj%20vo%20senka_2018.pdf

përkushtuar familjes / të afërmit e të dyshuarit, dhe 13% se ka një listë të avokatëve që bashkëpunojnë.

I pyetur nëse i dyshuari mund të konsultoheni me një avokat para marrjes në pyetje të parë, 67% thanë gjithmonë, 22% - nganjëherë, 6% - kurrë dhe 5% - shpesh.

I pyetur nëse ai lejohet të avokatit për të këshilluar personin gjatë marrjes në pyetje, 37% thanë gjithmonë, 26% - asnjëherë, 21% - ndonjëherë 16% - shpesh, "tregojnë anketat e institucioneve të lartpërmendura.

Sipas këtyre hulumtimeve, në pjesën e detyrimeve të pashpenzuara, detyrimet e paspecifikuara lidhur me detyrimet për trajtimin e personave të ndaluar dhe detyrimet për mbrojtësit e angazhuar kryhen sipas detyrës zyrtare. Këto lloje shpenzimesh përbëjnë përafërsisht 5.46% në 34.85% në gjykatat individuale. Nga analiza e llogarive vjetore dhe raporteve vjetore të buxhetit të gjykatës, Shoqata arriti në përfundimin se në gjykata shpenzimet për avokatët janë një nga tre llojet më të rëndësishme të detyrimeve të papaguara të negociatave (së bashku me kontraktimin dhe shërbimet komunale). Këto tri lloje shpenzimesh përbëjnë pothuajse 95% të totalit të detyrimeve të vonuara dhe të papaguara.

Sipas Shoqatës së Avokatëve, madhësia dhe struktura e tyre përcaktojnë nevojën për racionalizimin e ardhshëm të shpenzimeve të tjera, si dhe për sigurimin e burimeve shtesë të fondeve për të cilat këto kosto do të financohen pa kosto. Konkluzione të tilla vënë në pikëpyetje interesin e avokatëve më me përvojë për të ofruar shërbimet e tyre, si dhe cilësinë e përfaqësimit të të pandehurve ", është përmbledhur në analizën e të drejtës për qasje në avokat në procedurën penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹⁸.

2.3.2 Jo aktiviteti i avokatëve zyrtarë pa pagesë¹⁹

Edhe përkundër joaktivitetit të disa nga mbrojtësit zyrtarë, ekipet e monitorimit sipas raporteve të lartpërmendura nuk vërejtën që ndonjë rast në të cilin gjykatësi reagoi për mbrojtje joadekuate. Këtu po theksohet se sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjykatat e kanë patjetër të reagojnë kur të vërejnë një mbrojtje joadekuate nga ana e mbrojtësve zyrtarë ose për një mbrojtje të tillë të kuptojnë në formë tjetër.

¹⁸ <https://akademik.mk/analiza-pravo-na-pristap-do-advokat-vo-krivichnata-postapka-vo-republika-makedonija/>

¹⁹ Ligji për ndihmë juridike falas ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 161/2009, 185/2011, 27/2014 dhe 104/2015)

Lëshimet më të mëdha në sistemin e sigurimit të mbrojtësve sipas detyrës zyrtare janë mosekzistenca e rregullave të qarta gjatë përcaktimit, si dhe mosveprimi i atyre mbrojtësve pas mbarimit të procedurës në shkallë të parë. Mbrojtës sipas detyrës zyrtare cakton gjykata nga lista e vetë interne të avokatëve të interesuar. Avokatët në ato lista janë zakonisht të rinjë dhe angazhimin e tyre si mbrojtës sipas detyrës zyrtare e shfrytëzojnë për të fituar përvojë. Nuk ekziston ndonjë sistem për përzgjedhje të rastësishme të mbrojtësit nga ana e regjistrimit zyrtarë.

Kjo situatë kontribuon në krijimin e një lirie të madhe të gjykatave gjatë vendosjes se cili mbrojtës të caktohet. Kompenzimin që e marrin avokatët zyrtarë është dyfish më i vogël sesa ai i përcaktuari me tarifën e avokatëve. Ekipi mbikqyrës nga ana e avokatëve zyrtarë u informua se gjykatat kompenzimin e paguajnë me vonesa të mëdha, shumë shpesh ndodhë që pagesat të bëhen pas përfundimit të plotë të procesit gjyqësorë. Kjo në mënyrë plotësuese e sjell në pikëpyetje efektivitetin e mbrojtjes. Mbrojtësit zyrtarë marrin kompenzim vetëm për përfaqësimin e tyre në shkallën e parë.

Për shkak të kësaj situatë ata nuk dërgojnë ankesa për aktgjykimet e shkallës së parë. Mos shfrytëzimi i mjeteve juridike mund të ketë pasoja negative për palet, veçanërisht për ata që ndodhen në paraburgim apo burg, nuk e njohin gjuhën maqedonase, ose janë analfabetë.

KAPITULLI III

Metodologjia e Hulumtimit

III. METODOLOGJIA E STUDIMIT

3.1 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i këtij studimi është që nëpërmjet të përshkrimit të konceptit të institutit të avokatisës dhe strukturimit të saj në sistemin shoqëror e gjyqësor të jepet një pasqyrë reale të gjendjes aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke u bazuar tek të dhënat paraprake të institucioneve relevante si dhe nga ana tjetër sipas parametrave statistikore, vlerësimit të qëndrimeve të vetë avokatëve dhe analizave komparative të verifikohet efikasiteti dhe vendndodhja stukturore të institutit të avokatit në sistemin ligjor në tërësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke analizuar me statistikë deskriptive dhe konkluzive qëndrimet e avokatëve dhe dallimet potenciale në mes tyre sipas parametrave socio-demografike.

Në tërësi i gjithë materiali synon të krijojë një tablo të qartë mbi punën dhe natyrën e avokatit në procedurat penale si dhe vendndodhjen e avokatisë në sistemin shoqëro-gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.2 Fokusi dhe detyrat e hulumtimit

Pra, siç cekëm edhe më sipër me këtë hulumtim krijohet një pasqyrë reale e gjendjes aktuale të institutit të avokatisës dhe strukturimit të saj në sistemin shoqëror e gjyqësor të jepet një pasqyrë reale të gjendjes aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

a). Detyra e hulumtimit ishte që të evidentojë pozicionin e institutit të avokatisë në sistemin politik, shoqëror dhe gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe

c). Detyrat tjera esenciale të hulumtimit ishte që nëpërmjet konstatimeve të fituara të senzibilizohet sistemi shtetëror në tërësi si dhe opinionin i gjërë duke përfshirë popullatën në tërësi si dhe studijuesit e ardhshëm në këtë fushë dhe për të patur një pasqyrë reale e aktualitetit me institucionin e avokatisë dhe të drejtave themellore për mbrojtje dhe përfaqësim në vend.

3.3 Metodatat e hulumtimit

Çdo punim shkencor për ti realizuar detyrat e përcaktuara me sukses, është e domosdoshme që të zbatohet metodatat hulumtuese shkencore. Metodatat hulumtuese si sistem i të menduarit, të dëgjuarit dhe aktivitetëve fizike, përbëjnë instrumentin për realizimin e hulumtimit

dhe si të tilla duhet të mundësojnë verifikim objektiv dhe të hershëm të hipotezave të ngritura. Me konceptin metodë në një shkencë kuptohet zakonisht rruga apo mënyra e studimit të lëndës së asaj shkence, për të njohur ligjësitë themelore që vlejnë për fenomenet që i studion ajo.

Në kuptimin leksikor fjala metodë rrjedh prej gjuhës greqishte *methodos* që në përkthim do të thotë mënyrë, rrugë, veprim, qëndrim që përdoret për arritjen e një qëllimi të caktuar, për të ardhur te njohurti, për të zbuluar të vërtetën.

Pra, koncepti i metodës përdoret në kuptime të ndryshme. Pos tjerash, ajo domethënë mënyrë e përgjithshme e të afruarit të dukurive në rastin konkret në lëmin e shkencave shoqërore, paraqet mënyrën e përgjithshme të hulumtimit në fazat e ndryshme të tij. Zgjedhja e metodave për hulumtim është e kushtëzuar nga karakteri teorik e qëllimi i hulumtimit, shumëllojshmëria e problemit, si dhe mundësia objektive për mbledhjen e përgjigjeve teorike dhe të dhënave empirike. Në këtë drejtim, ky punim kërkon aplikimin e:

- metodës dialektike,
- metodën e analizës së përmbajtjes,
- sintezën,
- induksionin,
- deduksionin,
- metodën historike,
- metodën krahasore.

Natyra e ndërlikuar e punimit na kushtëzon për aplikimin e metodës dialektike, e cila është si metodë më e përgjithshme për arritjen e njohurive shkencore. Me aplikimin e kësaj metode objekti i hulumtimit do të vështrohet në tërësi me të gjitha lidhjet dhe marrëdhëniet e tij të jashtme dhe të brendshme.

Analiza është metoda e parë dhe bazike për njohje dhe zbërthimin të përgjithshëm teorik dhe praktik të objekteve të ndërlikuara të njohjes. Aplikimi i kësaj metode ka për qëllim studimin teorik, përshtatje profesionale të literaturave kombëtare dhe ndërkombëtare, studimin e akteve normative që janë në fuqi, si dhe dokumenteve që kanë lind nga procesi i zbulimit. Gjithashtu, zbardhjen dhe argumentimin e veprave penale ku duke njohur të gjitha faktorët e një dukurie, si të arrimë deri te përgjigjja e pyetjes çka, si dhe sa ka qenë e përmendur, apo përfolur në rrafshet të ndryshme dukuria që është objekt i hulumtimit tonë.

Në të kundërtën e analizës, sinteza është proces i të menduarit, me të cilën bëjmë njohjen e përgjithshme të një dukurie në bazë të njohjes së çdo pjese veç e veç të një dukurie, që është objekt i studimit.

Induksioni dhe deduksioni si mënyra të konstatimit përdoren për analizimin e taktikave të ndryshme të dëgjimit, ku në bazë të rasteve të veçanta do të arrijmë deri te një rregull e përgjithshme, përkatësisht si nga një rregull e përgjithshme do të nxjerrim konstatim përkatës të posaçëm.

Metoda historike na ofron mundësinë që të njihemi me zgjidhjet ligjore më të hershme, duke pa evoluimin e këtyre rregullave ligjore për të konstatuar se a kemi pasur zhvillim pozitiv në këtë drejtim apo jo.

Metoda krahasuese merret me vlerësimin e pozitës dhe rolit që ka procesi i marrjes në pyetje të dyshuarin për zbardhjen dhe zbulimin e veprës penale, duke e shikuar nga këndvështrimi i rregullimit procedural penal aktual dhe, duke e krahasuar me format e mëparshme këtë proces, në këtë mënyrë do të na ofrohen të dhëna për të rejtat e këtij ligji krahasuar me atë të mëparshmin.

Metoda komparative merret me konstatimin e ngjajshmërive dhe ndryshimeve midis dukurive të ndryshme, qofshin natyrore apo shoqërore, dhe në këtë mënyrë zbulohen vetitë kryesore të atyre dukurive të cilat i krahasojmë.

3.4 Teknikat dhe Instrumentet e hulumtimit

a). Analizat e literaturës dhe dokumentacionit relevant sidomos raporteve vjetore të Institucioneve relevante joqeveritare vendase dhe të jashtme, raporteve evropiane, Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë ku përfshihen analizat statistikore të punës së të gjitha Gjykatave sipas nivelit në republikë prej 2008-2017, e tjerë.

b). Pyetësi apo anketari të formës së jo i strukturuar, me pyetje të mbyllura apo me alternative të parapara edhe atë të kombinuara sipas shkallës së Likertit dhe sipas strukturës së thjesht pohuese apo mohuese. Anketari përbëhet nga 12 pyetje- pohime të cilët në fund japin një vlerësim dhe perceptim në tërësi për opinionin apo mendimin e avokatëve për gjendjen dhe vendndodhjen e institutit të avokatisë në përgjithësi si në sistemin shoqëror poashtu edhe në atë gjyqësor në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.


3.5 Pjesmarrësit në hulumtim



Pra, siç cekëm edhe më lart popullacioni në këtë hulumtim apo mostra e shënjestruar (target sample) do të jenë avokatë nga qytetet e Maqedonisë perëndimore edhe ato të Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe Dibrës.

Gjithsejt në numër u anketuan 58 avokatë më përvojë punë të ndryshme prej njëri tjetrit si dhe të profileve të ndryshme avokatie, frekeuncat si vijojnë më poshtë tek Tabela 1 dhe Grafiku 1, 2 dhe 3:

Tabela 1. Të anketuarit sipas Gjinisë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja Komulative
Mashkull	40	69.0	69.0	69.0
Femër	18	31.0	31.0	100.0
Total	58	100.0	100.0	





KAPITULLI IV

Prezantimi i rezultateve

IV. PREZANTIMI I REZULTATEVE DHE FREKUENCAT SIPAS QËNDRIMEVE TË AVOKATËVE

4.1 Gjendja aktuale sipas qëndrimeve të avokatëve


Pra, siç cekëm edhe më lart tek pjesa metodologjike e studimit popullacioni në këtë hulumtim apo mostra e shënjestruar (target sample) do të jenë avokatë nga qytetet e Maqedonisë perëndimore edhe ato të Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe Dibrës. Gjithsejt në numër u anketuan 58 avokatë më përvojë punë të ndryshme prej njëri tjetrit si dhe të profileve të ndryshme avokatie të drejtës qytetare, penale, administrative, tregtare dhe kushtetuese.

Duke u bazuar tek qëllimi kryesor i studimit që nëpërmjet të përshkrimit të konceptit të institutit të avokatisës dhe strukturimit të saj në sistemin shoqëror e gjyqësor të jepet një pasqyrë reale të gjendjes aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke u bazuar tek të dhënat paraprake të institucioneve relevante si dhe nga ana tjetër sipas parametrave statistikore, vlerësimit të qëndrimeve të vetë avokatëve dhe analizave komparative të verifikohet efikasiteti dhe vendndodhja stukturore të institutit të avokatit në sistemin ligjor në tërësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke analizuar me statistikë deskriptive dhe konkluzive qëndrimet e avokatëve dhe dallimet potenciale në mes tyre sipas parametrave socio-demografike.

Pra, pas grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave nga pyetësi me pyetje të mbyllura apo me alternative të parapara edhe ato të kombinuara sipas shkallës së Likertit e cila përbëhet nga 12 pyetje- pohime të cilët në fund japin një vlerësim dhe perceptim në tërësi për opinionin apo mendimin e avokatëve për gjendjen dhe vendndodhjen e institutit të avokatisë në përgjithësi si në sistemin shoqëror poashtu edhe në ate gjyqësor në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, tek Tabela 2 më poshtë janë pasqyruar frekuencat për tri nivelet statistikore të sfidës apo natyrës së avokaturës në sistemin politiko-shoqërore e gjyqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pra, sipas të dhënave nga Tabela 2 më poshtë dhe Grafiku 4 mund të themi se 43.1% të avokatëve të anketuar në këtë studim deklarojnë se sfidat në sistem si avokat janë mesatarisht të ballafaqeshme përkundër 34.5% të cilët deklarojnë se sfidat janë të rënda si avokat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe 22.4% që deklarojnë se sfidat janë në suazat e normalitetit si çdo punë dhe profesion tjetër.

Tabela 2. Avokatia dhe sfida e saj në sistemin shoqëror dhe gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja valide	Përqindja Komulative
Rëndë	20	34.5	34.5	34.5
Mesatar	25	43.1	43.1	77.6
Normal	13	22.4	22.4	100.0
Total	58	100.0	100.0	



Sipas frekuencave të parashtruara më sipër mund të themi se shumica e avokatëve të anketuar (rëndë dhe mesatar) deklarojnë se sfidat e ballafaqimit të profesionit të avokatisë me sistemin aktual gjyqësor me pretekst rëndësisë e avokatit në procedurat penale janë të rënda dhe komplekse e cila konstatim poashtu konfirmohet tek tabela 3 më poshtë ku janë të parashtruara parametrat statistikore të shpërndarjes së qëndrimit në mostër, pra, sipas renditjes së mesatares, modës dhe medianës si dhe koeficienti negative i Kourtoisis -0.218 tregon që qëndrimet e avokatëve kanë shpërndarje asimetrike negative, pra, dominojnë deklaratat negative dhe me të konstatojmë se institute i avokatisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas vetë avokatëve, është sfida e rëndë që shfaqet si e pafuqishme ndaj sistemit shoqëror dhe gjyqësor.

Tabela 3. Statistikat descriptive të shpërndarjes së qëndrimeve të avokatëve

Qëndrimi		
N	Valid	58
	Missing	0
Mesatare		34.53
Mediana		34.00
Moda		34 ^a
Devijimi stand.		4.152
Skewness		.242
Kurtosis		-.218
Minimum		26
Maximum		45

a. Multiple modes exist. The smallest value is shown

4.2 Analizat e qëndrimeve sipas dallimeve socio-demografike të avokatëve

Duke patur parasysh aspektet të ndryshme individuale që demonstron vetë individi dhe nga ana tjetër edhe profesioni i avokatisë, si dhe për të patur një korektësi shkencore në rezultatet e studimit, analizat e mëtejme do të vazhdojmë me analizat statistikore të dallimit të mesatareve edhe ate dallimet potenciale të qëndrimit të avokatëve sipas grupmohave të tyre, përvojës së tyre vitore si dhe tipit apo llojit të avokatisë.

Tek Tabela 4 më poshtë kolona e tretë janë pasqyruar mesataret e qëndrimeve sipas katër grupmohave të parashtruara tek anketari edhe ate grupmosha 21-30 (34.84), 31-40 (36.20), 41-50 (32.00) dhe mbi 50 (34.25).

Tabela 4. Dallimi i mesatareve të opinionit të avokatëve sipas grupmohave


Qëndrimi	N	Mesatare	Devijimi stand.	Gabimi stand.	95% besueshmëri	
					Poshtëm	Sipërm
					21-30	19
31-40	20	36.20	4.467	.999	34.11	38.29
41-50	15	32.00	3.024	.781	30.33	33.67
Mbi 50	4	34.25	3.304	1.652	28.99	39.51
Total	58	34.53	4.152	.545	33.44	35.63

Kurse tek Tabela 5 më poshtë kolona e fundit pasqyrohet sinjifikanca për dallimet e mesatareve të lartëpërmendura, pra, $p < 0.05$ (0.026) më e vogël se kufiri i dytë i besueshmërisë, me fjalë të tjera mund të themi se ekziston dallim sinjifikantë te qëndrimet e avokatëve sipas grupmoshës së tyre edhe atë qëndrime pozitive shfaqin avokatët e grupmoshave 31-40 (36.20), 21-30 (34.84), përkundër avokatëve të grupmoshave 41-50 (32.00) dhe mbi 50 (34.25).

Tabela 5. Sinjifikanca për dallimet e lartëpërmendura ANOVA

Qëndrimi					
	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	153.955	3	51.318	3.345	.026
	828.476	54	15.342		
Total	982.431	57			

E gjithë kjo pasqyruar në formë grafike si më poshtë tek Grafiku 5:



Grafiku 5. Niveli i sfidës së avokatëve të anketuar sipas grupmoshës së tyre

Analizat në vijim i vazhdojmë duke kërkuar dallimin potencial tek qëndrimet e avokatëve sipas përvojës së tyre në vite me profesionin si avokat, pra a ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve për sfidat e ballafaqimit të institutit të avokatisë me sistemin shoqëror, politik dhe gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas përvojës së tyre si avokat.

Tek Tabela 6 më poshtë kolona e tretë parashtrohen mesataret e qëndrimit të avokatëve sipas përvojës së tyre në vite, edhe ate, prej 0-5 vjet (36.10), 5-10 (35.23), 10-20 (31.58) dhe 20-40 (34.33).

Tabela 6. Dallimet e mesatareve të opinionit të avokatëve sipas përvojës në profesion


Qëndrimi	N	Mesatare	Devijimi stand.	Gabimi stand.	95% besueshmëri	
					Poshtëm	Sipërm
0-5	10	36.10	3.784	1.197	33.39	38.81
5-10	30	35.23	4.360	.796	33.61	36.86
10-20	12	31.58	3.204	.925	29.55	33.62
20-40	6	34.33	3.011	1.229	31.17	37.49
Total	58	34.53	4.152	.545	33.44	35.63

Tek Tabela 7 më poshtë kolona e fundit parashtrohet sinjifikanca për dallimet e lartëshënuara të mesatareve edhe sipas asaj $p < 0.05$ (0.035) më e vogël se kufiri i dytë i besueshmërisë, me fjalë të tjera mund të themi se ekziston dallim sinjifikantë te qëndrimet e avokatëve sipas viteve përvoj si avokat edhe ate qëndrime pozitive shfaqin avokatët me përvojë prej 0-5 vjet (36.10), 5-10 (35.23) përkundër 10-20 (31.58) dhe 20-40 (34.33).

Tabela 7. Sinjifikanca për dallimet e lartëpërmendura ANOVA

Qëndrimi	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	143.914	3	47.971	3.089	.035
	838.517	54	15.528		
Total	982.431	57			

Kjo situatë e ekzistimit të dallimit sinjifikantë të qëndrimeve e avokatëve sipas viteve përvoj si avokat qart pasqyrohet dhe shihet tek Grafiku 6 më poshtë, por parasegjithash vlen të potencohet nga rezultatet se grupmosha 41-50 të avokatëve të anketuar si dhe avokatët me përvojë pune 10-20 vjet kanë qëndrime më negative në këtë studim apo deklarojnë se shumë rëndë është ballafaqimi i institutit të avokatisë me sistemin aktual shoqëror, politik dhe gjyqësor dhe se vështirësitë dhe pengesat janë më se evidente tek procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Grafiku 6. Niveli i sfidës së avokatëve të anketuar sipas përvojës (vite) me profesionin

Dhe së fundi vijojnë analizat e dallimeve potenciale të qëndrimeve të avokatëve sipas llojit të avokatisë që bëjnë ato. Pra, tek Tabela 8 më poshtë kolona e tretë parashtrohen mesataret e qëndrimeve sipas llojit të avokatisë edhe ato të drejtës qytetare (35.64), drejtës penale (33.17), drejtës administrative (33.50), drejtës tregtare (38.67) dhe drejtës kushtetuese (37.00).

Tabela 8. Dallimet e mesatareve të opinionit të avokatëve sipas llojit të avokatisë

Qëndrimi

Qëndrimi	N	Mesatare	Devijimi stand.	Gabimi stand.	95% besueshmëri	
					Poshtëm	Sipërm
Drejtën Qytetare	22	35.64	4.478	.955	33.65	37.62
Drejtën Penale	29	33.17	3.771	.700	31.74	34.61
Drejtën Administrative	2	33.50	2.121	1.500	14.44	52.56
Drejtën Tregtare	3	38.67	1.528	.882	34.87	42.46
Drejtën Kushtetuese	2	37.00	2.828	2.000	11.59	62.41
Total	58	34.53	4.152	.545	33.44	35.63


Kurse te Tabela 9 më poshtë poashtu tek kolona e fundit parashtrohet sinjifikanca për dallimet e mesatareve të lartëshënuara, edhe ate $p < 0.05$ (0.049) më e vogël se kufiri i dytë i besueshmërisë, me fjalë të tjera mund të themi se ekziston dallim sinjifikantë te qëndrimet e

avokatëve sipas llojit të avokatisë që bën edhe ate qëndrime pozitive shfaqin avokatët të drejtës tregtare (38.67) dhe drejtës kushtetuese (37.00) përkundër avokatëve të drejtës qytetare (35.64), drejtës penale (33.17), drejtës administrative (33.50) në këtë studim.

Tabela 9. Sinjifikancat për dallimet e lartpërmendura ANOVA

Qëndrimi	Shuma e katrorëve	df	Mesatare në katror	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	146.036	4	36.509	2.313	.049
Total	836.396	53	15.781		

E gjithë kjo pasqyruar në formë grafike si më poshtë tek Grafiku 7:



Grafiku 7. Niveli i sfidës së avokatëve të anketuar sipas llojit të avokatisë

KAPITULLI V

Diskutimi dhe Përfundimi

V. PËRMBLEDHJA E KONKLUDIMEVE DHE DISKUTIMI

5.1 Përmbledhja e konkludimeve

- 43.1% të avokatëve të anketuar në këtë studim deklarojnë se sfidat në sistem si avokat janë mesatarisht të ballafaqeshme përkundër 34.5% të cilët deklarojnë se sfidat janë të rënda si avokat në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe 22.4% që deklarojnë se sfidat janë në suazat e normalitetit si çdo punë dhe profesion tjetër. Nëse i referohemi hulumtimeve relevante të viteve të fundit si ato analitike të Komitetit të Helsinkut dhe ato të Proektit „Rrjeta 23,, e financuar nga Bashkimi evropian dhe Mbretëria e Holandës mund të themi se këto rezultate korespondojnë me rezultatet të tilla të 2015 dhe 2017 ku në mënyrë eksplicite potencohet pafuqia e institutit të avokatisë dhe instituteve tjera gjyqësore të ballafaqohen me sistemin gjyqësor i cili edhe nga raportet e ndërkombëtarëve sidomos ato evropiane targetohet si më i koruptuari dhe më i politizuari prej ku edhe rrjedhin këto deklarat të avokatëve të anketuar si në këtë hulumtim poashtu edhe tek hulumtimet në fjalë.
- pra, dominojnë deklaratat negative dhe me të konstatohet se institute i avokatisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas vetë avokatëve, është sfidë e rëndë që shfaqet si e pafuqishme ndaj sistemit shoqëror dhe gjyqësor.
- ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve sipas grupmoshës së tyre edhe atë qëndrime pozitive shfaqin avokatët e grupmoshave 31-40 (36.20), 21-30 (34.84), përkundër avokatëve të grupmoshave 41-50 (32.00) dhe mbi 50 (34.25). Sipas analizave ky konstatim është më se e pritur duke e ditur faktin që grupmoshat mbi 41 vjet kanë përvojë më të madhe në profesionin dhe në labirintet gjyqësore prandaj edhe shfaqin deklaratat të tilla pesimiste apo negative që profesioni i avokatisë është sfidë e rëndë për efikasitet në sistemin gjyqësor apo në procedurat penale duke u shfaqur si jo i fuqishëm ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi.
- ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimit të avokatëve sipas viteve përvojë si avokat edhe atë qëndrime pozitive shfaqin avokatët me përvojë prej 0-5 vjet (36.10), 5-10 (35.23) përkundër 10-20 (31.58) dhe 20-40 (34.33). Gjithashtu ky konstatim përputhet me konstatimet e mësipërme.

- vlen të potencohet nga rezultatet se grupmosha 41-50 të avokatëve të anketuar si dhe avokatët me përvojë pune 10-20 vjet kanë qëndrime më negative në këtë studim apo deklarojnë se shumë rëndë është ballafaqimi i institutit të avokatisë me sistemin aktual shoqëror, politik dhe gjyqësor dhe se vështirësitë dhe pengesat janë më se evidente tek procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Poashtu edhe ky konstatim përputhet me rezultatet e të Proektit „Rrjeta 23,, e finansuar nga Bashkimi evropian dhe Mbretëria e Holandës mund të themi se këto rezultate korespondojnë me rezultatet të tilla të 2015 dhe 2017 ku qartë potencohet vështirësia e sistemit gjyqësor për të vepruar në situata delikate siç janë ato të sigurimit të avokatit për individët që nuk posedojnë finansa në nivel të duhur, apo mos aktiviteti i avokatëve zyrtarë në raste sociale, si dhe potencimi i nivelit të të ardhurave nga ky profesion sidomos nga avokatët më të vjetër dhe më me përvojë në profesion.
- ekziston dallim sinjifikantë te qëndrimet e avokatëve sipas llojit të avokatisë që bën edhe ate qëndrime pozitive shfaqin avokatët të drejtës tregtare (38.67) dhe drejtës kushtetuese (37.00) përkundër avokatëve të drejtës qytetare (35.64), drejtës penale (33.17), drejtës administrative (33.50) në këtë studim. Duke u referuar në natyrën e avokaturës së të drejtës tregtare dhe kushtetuese që shfaqin qëndrime më pozitiviste përkundër të drejtës qytetare, penale dhe administrative mund të themi se poashtu ky konstatim është më se i pritur duke pas parasysh se popullata e „thjesht,, po kalon procedurat qytetare dhe penale më shpesh përkundër atyreve tregtare ku edhe pagesat janë më konkrete dhe precise.

5.2 Përfundim dhe rekomandime

Duke u referuar qëllimit kryesor të këtij studimi që nëpërmjet të përshkrimit të konceptit të institutit të avokatisës dhe strukturimit të saj në sistemin shoqëror e gjyqësor të jepet një pasqyrë reale të gjendjes aktuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke u bazuar tek të dhënat paraprake të institucioneve relevante si dhe nga ana tjetër sipas parametrave statistikore, vlerësimit të qëndrimeve të vetë avokatëve dhe analizave komparative të verifikohet efikasiteti dhe vendndodhja stukturore të institutit të avokatit në sistemin ligjor në tërësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke analizuar me statistikë deskriptive dhe konkluzive qëndrimet e avokatëve dhe dallimet potenciale në mes tyre sipas parametrave socio-demografike, si dhe dy objektive kryesore të studimit në formë detyreje që të evidentojë pozicionin e institutit të

avokatisë në sistemin politik, shoqëror dhe gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe detyrat tjera esenciale të hulumtimit ishte që nëpërmjet konstatimeve të fituara të sensibilizohet sistemi shtetëror në tërësi si dhe opinioni i gjërë duke përfshirë popullatën në tërësi si dhe studijuesit e ardhshëm në këtë fushë dhe për të patur një pasqyrë reale e aktualitetit me institucionin e avokatisë dhe të drejtave themelore për mbrojtje dhe përfaqësim në vend, si përfundim mund të themi dhe të konkludojmë se qëllimi u arritë duke na siguruar tek pjesa teorike e studimit një analizë konçize si të nocionit të institutit të avokatisë në përgjithësi ashtu edhe një pasqyrë reale të gjendjes aktuale të profesionit të avokatisë në sistemim shtetëror dhe gjyqësor me pretekst të veçantë tek procedurat penale.

Kurse nga ana tjetër me anë të anketimit për vlerësimin e gjendjes aktuale të rëndësisë dhe rrollit të profesionit të avokatisë në sistemin gjyqësor ku u konstatua se dominojnë deklaratat negative dhe me të konstatojmë se institute i avokatisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas vetë avokatëve, është sfidë e rëndë që shfaqet si e pafuqishme ndaj sistemit shoqëror dhe gjyqësor, më pas se ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimet e avokatëve sipas grupmohës së tyre, poashtu ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimet e avokatëve sipas viteve përvoj si avokat dhe se ekziston dallim sinjifikantë të qëndrimet e avokatëve sipas llojit të avokatisë që bën, pra, me këto rezultate u kompletua edhe qëllimi bazë e hulumtimit duke koresponduar me rezultatet e hulumtimeve relevante të sektorit joqeveritar dhe përmbajtjes së raporteve evropiane për nivelin e ecurisë së Republikës së Maqedonisë së veriut në strukturën e demokracisë.

Nga gjithë kjo e potencuar më sipër mund të formulojmë disa rekomandime të cilët shpesh edhe hasim tek analizat dhe studimet e sektorit joqeveritar por poashtu edhe tek rekomandimet evropiane për reformat në sistemin gjyqësor.

Pra, sipas kësaj nevojitet një riformulim ose saktësim plotësues i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën mbrojtjes, ligjit të avokatësisë, duke precizuar bukur mirë të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale në pjesën e përcaktimit të momentit nga i cili personave të dyshuar dhe të akuzuar duhet t'u sigurohet e drejta, përkatësisht të sigurohen të drejtat në fillim të procedurës paraprake që mbahet para policisë dhe/ose prokurorisë publike. Autoritetet duhet të përpiqen për përfshirjen e përkthyesve dhe interpretuesve në Listën me emra të përkthyesve të përhershëm gjyqësor, të cilët njohin gjuhë të ndryshme nga ato 25 për të cilat ekzistojnë përkthyes, përkatësisht interpretues. Në praktikë, përkthyesi dhe interpretuesi duhet ta flasin gjuhën amë, e jo gjuhën që i akuzuari e kupton pjesërisht.

Poashtu në suazat e ligjit për të drejtën e mbrojtjes dhe avokatisë duhet të zhvillohet mekanizëm ligjor dhe praktik për të përcaktuar nëse personi i dyshuar ose i akuzuar e flet dhe e kupton gjuhën e procedurës penale, a ka nevojë për ndihmën e interpretuesit dhe nëse përkthimi dhe interpretimi janë me cilësi që siguron mbrojtje të drejtësisë në procedurë. Ky mekanizëm duhet të aplikohet edhe në kontrollin e cilësisë së përkthimit, përkatësisht interpretimit dhe mundësisë që nëse kjo cilësi është e dobët, interpretuesi ose përkthyesi të zëvendësohet.

Nevojitet miratimi i dispozitës ligjore në të cilën vendimi për privim nga liria, kallëzimi penal, propozim/aktakuza, cilido qoftë aktgjykim, si dhe dokumentet tjera që llogariten si thelbësore do të konsiderohen si dokumente që doemos duhet të përkthehen, si dhe mundësia që të dyshuarit, të akuzuarit dhe avokatët e tyre përkthimin e tillë ta kërkojnë nëpërmjet parashtrësës përkatëse dhe të arsyetuar.

Nevojitet miratim i dispozitave ligjore nëpërmjet të cilave personat e dyshuar dhe të akuzuar do të njoftohen për të drejtën e ndihmës falas juridike dhe kushtet në të cilat ajo mund të realizohet, si dhe përcaktimi i obligimit që personat, të cilët janë të privuar nga liria, të njoftohen për të drejtën e interpretuesit dhe përkthyesit gjatë procedurës policore. Nevojitet edhe miratimi i dispozitës nëpërmjet të cilës do të përcaktohet se policia dhe organet e tjera gjyqësore, duhet të kenë parasysh çfarëdo qoftë nevoje të veçantë të personave vulnerabil të cilët janë të dyshuar ose të akuzuar. Për implementimin e këtij rekomandimi në praktikë është mirë që në lokalet e policisë dhe organeve gjyqësore të ekzistojnë broshura, në disa gjuhë botërore, nëpërmjet të cilave të akuzuarit mund të njoftohen me këtë të drejtë. Ligji për ndihmë juridike falas të ndryshohet në mënyrë që të lehtësohen kriteret për realizimin e të drejtës së ndihmës juridike falas. Diskriminimi të vendoset si sferë në të cilën mundet të lejohet ndihma juridike falas.

Mbrojtja e të drejtave të individit, zhvillimi i një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, do të mund të sigurohet më mirë nëpërmjet ndihmës juridike, që avokati, si përfaqësues i interesave të ligjshme të individit i siguron atij. Pavarësia e avokatit është aq e nevojshme për të besuar në procesin e drejtësisë dhe në paanshmërinë e gjyqtarit. Avokatia dhe gjyqësori, në bashkëpunim me njëritjetrin, do të sigurojnë standarde dhe respektim të të drejtave të individit në shoqëri. Reforma në drejtësi kërkon edhe reformim të institutit të avokatisë, ku avokati në ndihmë të gjykatës, me profesionalizëm dhe ndershmëri, duke zbatuar dhe respektuar

ligjet në fuqi, si dhe Kodin e Etikës së Avokatit duhet t'i shërbejë dhënies së drejtësisë, dhe forcimit të shtetit ligjor. Vetëm një institut avokatie i reformuar sipas standardeve ndërkombëtare, do të mund të realizojë një ndihmë ligjore adekuate, dhe të mbështesë gjykatën që të gjykojë me drejtësi.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Fenwick H. Procedural “rights” of victims of crime: Public or private ordering of the criminal justice process?. *The Modern Law Review* 1997 May;
- Miers D. The responsibilities and the rights of victims of crime. *The Modern Law Review* 1992
- Ben-Shahar O. Blaming the Victim: Optimal Incentives for Private Prosecutions Against Crime. *Journal of Law, Economics & Organization* 1995 Oct; 11(2): 434-455.
- Cutler AS. Why the good citizen avoids testifying. *Annals of the American Academy of Political and Social Science: Judicial Administration and the Common Man* 1953 May;
- The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/h_comp49.htm
- Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997).
- Дершовиц, А.(2010). Писма до младиот адвокат. Скопје: Арс Ламина ДОО
- Evans, K. (2004). *Common Sense Rules of Advocacy for Lawyers*. USA Virginia: The Capitol Net
- Gandhi, M.K.(2007). *An Autobiography or The story of my experiments with truth*. New Delhi: All India Congress Committee
- Krivicen Zakonik – Kodi Penal, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* nr.19, 30.03.2004
- Zakon Za Krivicna Postapka – Ligji për Procedurë Penale, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* nr. 15, 07.03.2005
- Kambovski, V. „E drejta penale„, Botimi i dyte 2007
- Franjo Baçiç, E drejta ndëshkuese e përgjithshme, botimi 1998
- Gjorgje Marjanoviç, E drejta penale Maqedone – pjesa e përgjithshme
- Nikola Matovski E drejta procedurale ndëshkuese, Botimi 2009
- Ejup Sahiti Argumentimi në procedurë penale, Botimi i dytë 2006
- Lupço Arnaudovski Përmbledhje e fakultetit juridik “Justiniani i parë” Shkup 2007

Vesel Latifi, Kriminalistika 2004

Тодор Витларов, Казнено право, Посебен дел со практични примери, авторизирани предавања, 2013 год.;

Janevski, A. Maksimovski, R. Arnaudovski, L. Kajalxhiev, G. Buzharovska, G. Cvetkovska, J. (2004) „Mbikëqyrja e implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykime të drejta në gjykatat e vendit dhe vlerësimi për funksionimin e gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë" - Raport përfundimtar- Koalicioni i shoqatave të qytetarëve “Të gjithë për gjykime të drejta"

Ross, D.(2007). Advocacy. Cambridge: Cambridge University Press

Stojanovski, V. Çallovski, N. (2014) „Të Drejtat dhe Liritë Themelore Civile dhe Politike,, – Shkup: Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të RM

Шкарик, С. (2007). Ганди како модел за македонскиот адвокат, Адвокатура, бр.22, 44-53

Nikola Matovski, Gordana Lazhetiq- Buzharovska, Gordan Kalajxhiev, Kazнено procesno pravo, Botimi i dytë i plotësuar dhe ndryshuar, Shkup, 2011

Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 2007

Закон за адвокатурата. Скопје: Службен весник на Р.Македонија. бр.59/02

Кодекс за професионална етика на адвокати, адвокатски стручни соработници и адвокатски приправници на Адвокатската комора на Р.Македонија (2011).Скопје: АКРМ -Статут на Адвокатската комора на Р.Македонија



Ligjet e referuara



- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare nr. 52/1991, 31/1998, 91/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009 dhe 49/2011);
- Ligji për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008 dhe 150/2010);
- Ligji për zbatimin e vendimeve të GJEDN (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.67/2009 dhe 43/2014);
- Ligji për shërbimin gjyqësor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/2014, 33/2015, 98/2015 dhe 6/2016);



- Ligji për prokurori publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.150/2007 dhe 111/2008);
- Ligji për shërbimin e prokurorisë publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2015, 231/2015 dhe 11/2016);
- Ligji për ndihmë juridike falas (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 161/2009, 185/2011, 27/2014 dhe 104/2015);
- Ligji për avokaturë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 59/2002, 60/2006, 29/2007, 106/2008, 135/2011, 113/2012 dhe 148/2015);
- Ligji për noteri (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 72/2016 dhe 142/2016);
- Ligji për përmbarim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 72/2016 dhe 142/2016); • Ligji për ndërmjetësim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 188/2013, 148/2015, 192/2015 dhe 55/2016);
- Kodi Penal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014, 41/2014, 115/2014, 132/2014, 160/2014, 199/2014, 196/2015 dhe 226/2015);
- Ligji për procedurë Penale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 150/2010, 100/2012 dhe 142/2016);
- Ligji për drejtësinë e fëmijëve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 148/2013);
- Ligji për zbatimin e sanksioneve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 2/2006, 57/2010, 170/2013, 43/2014, 166/2014, 33/2015, 98/2015 dhe 11/2016);



SHTOJCA



1. Grafikonet me frekuencat e përgjigjeve të anketarit (12 pyetje)















2. Pyetësi për Qëndrimet e avokatëve për profesionin e tyre, rrolin dhe rëndësin e tyre në procedurat penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Mosha	1. Prej 21-30	2. Prej 31-40	3. Prej 41-50	4. Mbi 50
Gjina		M	F	
Përvoja si avokat	1. Prej 0-5	2. Prej 5-10	3. Prej 10-20	4. Prej 20-40
Ju mirreni me	1. Drejtën Qytetare 2. Drejtën Penale 3. Drejtën Administrative 4. Drejtën Tregtare 5. Drejtën Kushtetuese			

1. Proçesin e arsimimit për t,u bërë avokat në Republikën e Maqedonisë së Veriut konsideroni si të vështirë, komplekse dhe të rëndë!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

2. Në Maqedoni profesioni i avokatit vlerësohet shumë nga ana e sistemit shoqëror si dhe zë pozitë kyçe në sistemin gjyqësor!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

3. Në krahasim me shtetet Evropiane, avokatura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është zhvilluar në nivel adekuat!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

4. Legjislativa aktuale e Republikës së Maqedonisë së Veriut mundëson të drejtat themelore civile gjatë procedurave penale!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

5. Ligjet aktuale të Republikës së Maqedonisë së Veriut mundësojnë të drejtën për përfaqësim dhe mbrojtje adekuate me parimet bazë humane!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

6. Sistemi aktual gjyqësor dhe avokatura në Republikën e Maqedonisë së Veriut mundëson mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e privatësisë sipas parimeve bazë humane!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

7. Avokatura është e pafuqishëm gjatë cënimit të drejtave themelore civile nga sistemi aktual gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

8. Cënimi i të drejtave themelore civile është edhe rezultat i joaktivitetit të avokatëve zyrtarë pa pagesë!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

9. Të ardhurat financiare në këtë profesion janë në nivel të duhur dhe motiv për punë më produktive!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

10. Ekziston konkurrence jolojale mes punës së avokatisë dhe shoqatave avokatie dhe kjo ndikon në produktivitetin dhe efikasitetin në profesionin e avokatit në Republikën e Maqedonisë së Veriut!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

11. Profesionin e avokatisë ka nevojë në mënyrë permanente të trajnohet, rikualifikohet, reformohet dhe të mbështetet nga sistemi shoqëror!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

12. Instituti i avokatisë vlerësohet dhe respektohet nga instancat gjyqësore në nivel të duhur!

Aspak nuk pajtohem Nuk pajtohem Neutral Pajtohem Plotësishtë pajtohem

Ju Falënderit!